



REPUBLIKA E KOSOVËS

MINISTRIA E INDUSTRIË,
NDËRMARRËSISË DHE TREGTISË



STUDIM I ZINXHIRIT TË VLERËS SË PËRPUNIMIT KIMIK TË KOSOVËS

RAPORT

TETOR 2023

STUDIM I ZINXHIRIT TË VLERËS SË PËRPUNIMIT KIMIK TË KOSOVËS

RAPORT

TETOR 2023



Implemented by
giz Deutsche Gesellschaft
für Internationale
Zusammenarbeit (GIZ) GmbH



REPUBLIKA E KOSOVËS
MINISTRIA E INDUSTRIË,
NDËRMARRËSISË DHE TREGTISË

Publikuar nga:

Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë

Rr. "Arbënor e Astrit Dehari", nr. 21.
Sheshi i Spitalit 10000 Prishtinë, Kosovë
T + 383 (0) 200 36 512
+383 (0) 200 36 543

E zkp.mti@rks-gov.net
I www.mint.rks-gov.net

dhe

Deutsche Gesellschaft für
Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH

Zyrat e regjistruara
Bonn dhe Eschborn, Gjermani

Zyra GIZ në Kosovë
Rr. Arkitekt Karl Gega Nr 38
10000 Prishtinë, Kosovë
T +383 38 233 002 100

E giz-kosovo-buero@giz.de
I www.giz.de/kosovo

Autor:

Anteja ECG
- Gerd Meier zu Köcker
- Mateja Dermastia

Dizajni/paraqitja:

Envinion

Kredite/burimet e fotografive:

Name Surname

Në emër të
Ministria Federale Gjermane për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (BMZ)

Prishtina, 2023

MOHIMI I PËRGJEGJËSISË

Ky studim është financuar nga GIZ. Ky mohim informon lexuesit se pikëpamjet, mendimet dhe opinionet e shprehura në këtë studim i përkasin vetëm autorëve dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht këndvështrimin e GIZ-it.

Raporti përfaqëson një studim të zinxhirit të vlerës, ai është hartuar përmes intervistave të thelluara me NVM-të e sektorit përgjatë funksioneve të zinxhirit të vlerës. Pikëpamja e autorëve është bazuar në të dhënat e mbledhura. Mostra mund të jetë përfaqësuese për kapjen e dinamikës së tendencave të tregut dhe zinxhirit të vlerës; megjithatë, mund të mos përfaqësojë një pasqyrë të saktë sasiore të industrisë së sektorit. Autorët e studimit nuk mund të jenë përgjegjës për asnjë pasojë që mund të lindë nga përdorimi i informacionit në këtë raport nga një palë e tretë. Nuk ka asnjë pretendim se informacioni i paraqitur në raport është plotësisht i saktë.

Tabela e Përmbajtjes

Lista e shkurtesave	6
Përmbledhje ekzekutive	7
Hyrje	9
1. Metodologjia	10
2. Trendet globale në industrinë kimike.....	12
3. Ilustrim i industrisë së Kosovës.....	15
3.1 Trendet e Tregtisë në Sektorin Kimik të Kosovës	17
3.2 Analiza e produktivitetit dhe konkurrueshmërisë me homologët e përzgjedhur.....	21
4. Harta e palëve të interesuara.....	25
5 Analiza e zinxhirit të vlerës	29
5.1 Harta e zinxhirit të vlerës së sektorit	29
5.2 Analiza e zinxhirit të vlerës: Pjesa e furnizimit	31
5.3 Analiza e zinxhirit të vlerës: Pjesa e prodhuesve	33
5.4 Aktiviteti dhe operacionet e biznesit	34
5.5 Tregjet vendore dhe ato të eksportit	36
5.6 Burimet Njerëzore.....	40
5.7 Inovacioni dhe dixhitalizimi	41
5.8 Peizazhi i rrjetëzimit.....	43
6. Politikat mbështetëse dhe rregullimi institucional.....	44
6.1 Promovimi dhe mbështetja e investimeve	46
6.2 Mbështetja e konkurrencës dhe inovacionit	47
6.3 Vlerësimi i Konformitetit dhe Kërkesat e Sigurisë së Eksportit	48
7. Mundësitë dhe barrierat.....	49
7.1 Mundësitë	49
7.2 Barrierat	50
8. Rekomandimet për ndërhyrje.....	52
9. Rruga përpara	63

Lista e shkurtesave

IA	Inteligjenca Artificiale
BH	Bosnja dhe Hercegovina
OAB	Organizatat Anëtare të Biznesit
KIE	Këshilli i Investitorëve Evropianë
CEFTA	Marrëveshja e Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore
CNC	Kontrolli Numerik Kompjuterik
ECIKS	Nisma Ekonomike për Kosovën
EA - MLA	Marrëveshja Shumëpalëshe e Akreditimit Evropian
ERP	Planifikimi i Burimeve të Ndërmarrjes
BE	Bashkimi Evropian
GIZ	Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH
HS	Sistemi i Harmonizuar i Përshkrimit dhe Kodimit të Mallrave
AGJBP	Agjenda e Gjellbër për Ballkanin Perëndimor
KPMM	Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale
ILAC – MRA	Marrëveshja e Njohjes së Ndërsjellë të Bashkëpunimit Ndërkombëtar për Akreditimin e Laboratorëve
API	Agjencia për Pronësi Industriale
DAK	Drejtoria e Akreditimit të Kosovës
ARBK	Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës
OEK	Oda Ekonomike e Kosovës
FKGK	Fondi Kosovar për Garanci Kreditore
KIESA	Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë
AMK	Agjencia e Metrologjisë së Kosovës
KPK	Klubi i Prodhuesve të Kosovës
AKS	Agjencia Kosovare e Standardizimit
MMPHI	Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
MFPT	Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
MIGA	Agjencia e Garancisë Shumëpalëshe të Investimeve
MINT	Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë
NMVM	Ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme
NACE	Nomenclature statistique des Activités économiques dans la Communauté Européenne
KKEI	Këshilli Kombëtar për Ekonomi dhe Investime
K dhe ZH	Kërkimi dhe Zhvillimi
MSA	Marrëveshja e Stabilizim Asociimit
NVM	Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme
ATK	Administrata Tatimore e Kosovës
QAP	Qendrat e Aftësimi Profesional
USAID	Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar

Përmbledhje ekzekutive

Ky raport është njëri nga raportet e hartëzimit të kllasterëve të cilët shqyrtojnë më në thellësi sektorët kryesor të përzgjedhur në Republikën e Kosovës. Sektori i përpunimit kimik është ende në një fazë embrionale, mirëpo ka treguar një model mbresëlënës të rritjes gjatë viteve të fundit. Përkundër faktit se Kosova mbulon vetëm përqindje të vogla të mbarë industrisë kimike, kryesisht në bojëra dhe veshje për qëllime ndërtimore, si dhe produkte për banja dhe dushe dhe të pastrimit për konsumatorët privatë, ky sektor nuk do të anashkalohet në të ardhmen. Shumë biznese kosovare kanë përfituar nga lulëzimi i industrisë globale të ndërtimit dhe kërkesa në rritje për produkte kozmetike dhe ato për kujdesin ndaj trupit, të cilat janë të shëndetshme dhe me burim natyral. Dhe perspektiva është mjaft premtuese, pasi këto industri pritet të rriten edhe më shumë në të ardhmen e afërt. Ashtu si në sektorët e tjerë, industria kosovare e përpunimit kimik ka përfituar nga sfidat e furnizimit si rezultat i pandemisë COVID-19 apo krizës në Ukrainë, duke qenë në gjendje të ofrojë furnizim të qëndrueshëm për blerësit rajonalë dhe ata evropianë.

Sektori kimik përfaqëson një sektor të vogël në krahasim me sektorët e tjerë industrialë në Kosovë, megjithatë, në vitet e kaluara ka shënuar trend të dukshëm të rritjes. Kjo rritje është nxitur kryesisht nga eksporti, ku gjatë periudhës 2017-2021 produkte specifike brenda sektorit kanë shënuar ritme të larta të rritjes së eksportit, mbi 175% për produkte për ngjyrosje dhe lyerje, dhe mbi 1000% për produkte si sapunë, shampona apo detergjente. Vendet nga rajoni dhe Evropa shfaqen si destinacionet kryesore të eksportit. Aktualisht, ky sektor regjistron mbi 300 kompani aktive, me mbi 1000 punonjës. Gjetjet nga intervistat me kompanitë e sektorit tregojnë se shkalla e shfrytëzimit të kapaciteteve prodhuese varion ndërmjet bizneseve ekzistuese, ku mesatarja arrin në rreth 70%.

Pavarësisht gjetjeve premtuese, sektori i përpunimit kimik është ende në fazën e saj embrionale. Studimi ka identifikuar një sërë pengesash që mund ta vështirësojnë zhvillimin e mëtejshëm të këtij sektori:

- Konkurrueshmëria e dobët e produkteve
- Sektori i përpunimit kimik dominohet nga ndërmarrjet mikro dhe të vogla
- Qasja e pasigurt në lëndën e parë
- Sektori është i krahaseshëm, i paorganizuar dhe ka lidhje të dobëta me subjektet ekzistuese mbështetëse
- Qasja e kufizuar në mbështetjen dhe financat publike
- Mungesa e njohurive teknike të përditësuara
- Njohuri të kufizuara për tregun
- Mungesa e trupave dhe laboratorëve certifikues pengon potencialin e eksportit

Bazuar në gjetjet e punës në terren, janë dhënë rekomandimet e mëposhtme, të cilat janë specifikuar më tej në Kapitullin 8.

Rekomandimi 1: Mbështetja e zhvillimit të fuqisë punëtore

Rekomandimi 2: Krijimi i një klasteri për përpunimin kimik, "Kllasteri Kimik - Kosovë"

Rekomandimi 3: Krijimi i një sistemi vauçer për të përmirësuar nivelin e dixhitalizimit brenda NMVM-ve

Rekomandimi 4: Përshtatja e peizazhit të mbështetjes për promovimin e eksporteve

Rekomandimi 5: Krijimi dhe zbatimi i një Fondi të Inovacionit

Rekomandimi 6: Zvogëlimi i varësisë së lëndës së parë nga jashtë

Rekomandimi 7: Krijimi i një sistemi të harmonizuar ndërkombëtarisht të vlerësimit të konformitetit

Këto rekomandime praktike janë paraparë të kontribuojnë në përmirësimin e qëndrueshëm të konkurrueshmërisë së sektorit kimik në Kosovë, si dhe të përmirësojnë qëndrueshmërinë e sektorit nga çrregullimet e furnizimit global.

Hyrje

Kur merren parasysh sektorët industrialë me potencial të madh të rritjes në Kosovë, vetëm disave u shkon në mendje sektori kimik. Kjo është e vërtetë, nga njëra anë, sepse ky sektor është relativisht i vogël dhe i mungojnë kompanitë tipike të industrisë kimike. Nga ana tjetër, kjo mund të anashkalojë nën-sektorët e industrisë kimike që tashmë kanë rëndësi të caktuar. Prandaj, ia vlen ta shqyrtojmë më në detaje strukturën industriale të sektorit kimik.

Sektori kimik aktualisht po ndikohet ndjeshëm nga dy ngjarje apo trende të veçanta. Nga njëra anë, pandemia COVID-19 dhe kriza aktuale në Ukrainë kanë rezultuar në një trend të dedikuar drejt shkurtimit të zinxhirëve ekzistues të vlerës. Blerësit evropianë po bëhen më të interesuar të sigurojnë burime nga Ballkani Perëndimor sesa nga vendet e jashtme. Furnizimi i vazhdueshëm dhe raporti i mirë çmim/cilësi kanë rëndësi, gjë që po kërkohet gjithnjë e më shumë nga blerësit ndërkombëtarë. Nga ana tjetër, trendi global drejt qëndrueshmërisë më të madhe po shkakton një ri-konsiderim dramatik të industrisë kimike. Sidomos për faktin se sektori kimik kërkon sasi të konsiderueshme të energjisë dhe në të kaluarën ka qenë përgjegjës për një sërë problemesh mjedisore në mbarë botën.

Industria kimike kosovare mund të përfitojë nga këto dy trende aktuale. Nga njëra anë, afërsia me tregjet e rëndësishme të eksportit është një përparësi e konsiderueshme, sepse furnizuesit kosovarë mund të garantojnë furnizim të sigurt. Nga ana tjetër, industria vendore mund të përmbushë kërkesën në rritje për produkte të përpunuara në mënyrë të qëndrueshme duke përdorur lëndë të para miqësore ndaj mjedisit dhe me burim natyral. Sidomos fakti që industria kimike në Kosovë dominohet nga kompanitë mikro dhe ato të vogla mund të jetë një përparësi në aspektin e fleksibilitetit dhe inovacionit.

Gjetjet në këtë raport janë nxjerrë nga intervistat me 47 kompani të sektorit kimik në Kosovë. Këto kompani përfaqësojnë një mostër të kompanive të sektorit të prodhimit bazuar në strukturën e përgjithshme të industrisë.

Ky Raport i Hartëzimit të Zinxhirit të Vlerës përmban gjetje të rëndësishme të destinuara për Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT) dhe mbështetet nga Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH, me qëllim të përmirësimit të konkurrueshmërisë së përgjithshme të sektorit kimik në Kosovë. Sektori i përpunimit kimik është anashkaluar ndër vitesh, por po shkon duke u ngjitur më lart në agjendën politike. Integrimi i mëtejshëm i industrisë së përpunimit kimik të Kosovës në zinxhirët e furnizimit global do të ofrojë një mundësi të madhe për rritje, inovacion dhe konkurrueshmëri të shtuar.

Raporti paraqet përfundime që nxjerrin në pah barrierat dhe kufizimet kryesore përgjatë zinxhirit të vlerës së industrisë kimike në Kosovë. Së fundi, në pjesën e fundit të raportit janë dhënë një sërë rekomandimesh dhe ndërhyrje të politikave që garantojnë përmirësimin e konkurrueshmërisë së sektorit.

1. Metodologjia

Në këtë raport të hartëzimit të zinxhirit të vlerës është aplikuar një metodologji e strukturuar që përfshin hulumtimin parësor dhe dytësor. Kjo i ka mundësuar ekipit hulumtues të zhvillojë një analizë të thellë të zinxhirit të vlerës së industrisë kimike, duke vlerësuar kufizimet, dinamikën dhe trendet e sektorëve, si dhe të propozojë rekomandime specifike për përmirësimin e konkurrueshmërisë së sektorit. Qasja metodologjike e detajuar është përshkruar më poshtë.

Aktiviteti i parë i ekipit hulumtues përbëhej nga hulumtimi nga zyra - analiza e raporteve dhe studimeve përkatëse për sektorin kimik në Kosovë, si dhe raportet për trendet rajonale dhe ato globale. Një nga rezultatet e këtij aktiviteti ka qenë përgatitja dhe prezantimi i hartës së zinxhirit të vlerës, e cila përshkruan procesin e akterëve dhe palëve të interesit sesi kanalizohet produkti nga prodhimi primar e deri tek konsumatori final. Harta e zinxhirit të vlerës së sektorëve kimikë paraqet akterët dhe palët e interesit të sektorit dhe rolin e tyre. Gjithashtu, është bërë mbledhja dhe analiza e statistikave zyrtare në lidhje me të dhënat e tregtisë. Ekipi hulumtues ka mbledhur të dhëna nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) dhe Dogana e Kosovës për të vlerësuar madhësinë e sektorit kimik dhe për të kuptuar më mirë dinamikën e sektorit, kërkesën e brendshme dhe trendet e rritjes.

Si pjesë e aktivitetit kërkimor parësor për këtë studim është kryer një anketë me kompanitë e sektorit kimik. Është hartuar një mostër përfaqësuese e kompanive, në bazë të së cilës janë intervistuar 47 kompani sektoriale. Mostra e anketës është nxjerrë në bashkëpunim të ngushtë ndërmjet ekipit hulumtues, MINT-së dhe GIZ-it. Mostra nuk është gjithëpërfshirëse për popullsinë, megjithatë ajo përbëhet prej sektorëve të veçantë të cilët janë vlerësuar si strategjikë nga MINT-ja dhe GIZ-i (Tabela 1).

Tabela 1: Lista e sektorëve kimikë të synuar përmes hulumtimit parësor

Prodhimi i ngjyrave, llaqeve dhe shtresave të ngjashme
Prodhimi i sapunit, detergjenteve dhe produkteve të pastrimit
Prodhimi i produkteve të tjera kimike me bazë inorganike
Prodhimi i ngjitësve
Prodhimi i fibrave sintetike
Prodhimi i plehrave kimike

Prodhimi i vajrave esenciale

Prodhimi i produkteve të tjera kimike me bazë organike

Prodhimi i gomës sintetike

Numri i kompanive të anketuara në mostër siguron një prag të mjaftueshëm, që tejkalon numrin minimal të observimeve për statistikat inferenciale. Kështu, kjo i ka mundësuar ekipit hulumtues që të zhvillojë analiza empirike.

Përveç intervistave, ekipi hulumtues ka kryer edhe detyra të mëtejshme për validimin dhe pastrimin e të dhënave. Në këtë raport të hartëzimit të zinxhirit të vlerës është përdorur një përzierje e të dhënave cilësore dhe sasiore, si nga kërkimi parësor ashtu edhe dytësor, prandaj ai përfaqëson një metodologji të fortë për analizën e zinxhirit të vlerës.

Në fund, u organizua një punëtori për validimin me akterë të sektorit kimik. Qëllimi i punëtorisë ka qenë prezantimi dhe vërtetimi i gjetjeve nga hulumtimi primar. Punëtorja u zhvillua në gusht të vitit 2022 dhe ka përfshirë akterë nga institucionet kombëtare dhe kompanitë e sektorit.

2. Trendet globale në industrinë kimike

Të dy nën-sektorët, bojërat dhe veshjet nga njëra anë, por edhe sapunët, detergjentet dhe produktet e pas-trimit nga ana tjetër, kanë përfituar fuqishëm nga rritja e ndjeshme e kërkesës në mbarë botën. Industria globale e bojërave dhe veshjeve u vlerësua në rreth EUR 160 miliardë në vitin 2021¹. Tregu i produkteve të banjave dhe dushit supozohet të arrijë vlerën prej EUR 48 miliardë në vitin 2023. Për sa i përket tregut të detergjenteve, ai është vlerësuar në EUR 120 miliardë në vitin 2021, dhe pritet të arrijë në EUR 175 miliardë në vitin 2031². Lulëzimi i këtyre nën-sektorëve, të cilët janë tregjet kryesore për bojërat dhe veshjet kosovare, si dhe për prodhuesit e sapunëve, detergjenteve dhe kozmetikës, siguruan kërkesë të vazhdueshme për produkte të tilla. Pandemia COVID-19 ka rritur gjithashtu kërkesën e konsumatorëve privatë për produkte dezinfektuese, por edhe për kozmetikë.

Pavarësisht perspektivës shumë premtuese, industria kosovare është nën transformim e sipër, dhe trendet e ardhshme janë të një rëndësie të madhe për tërë industrinë.

Ndikimi afatmesëm i pandemisë COVID-19

Edhe nën-sektorët e trajtuar në këtë studim janë goditur nga zinxhirët e furnizimit të çrregulluar si rezultat i shpërthimit të COVID-19. Si reagim, kompanitë aplikojnë vazhdimisht teknika inovative për të stabilizuar operimet e tyre. Përmirësimi i menaxhimit të stokut dhe magazinës ka ndihmuar në sigurimin e dërgesave me kohë. Mjetet dixhitale gjithashtu janë aplikuar gjithnjë e më shumë, sidomos në sektorin e kozmetikës, për të gjetur kanale të reja shitjesh gjatë periudhës së pandemisë COVID-19, pasi metodat tradicionale nuk funksiononin si duhet. Shumë prodhues të sapunëve, detergjenteve dhe kozmetikës natyrale, duke përfshirë ata nga Kosova, kanë krijuar kanale të reja të shitjes online për shkak të rregulloreve të ashpra të bllokimit, në mënyrë që të kontaktojnë më mirë klientët e tyre. Rrjedhimisht, Pandemia COVID-19 i dha një shtysë të konsiderueshme dixhitalizimit të këtij sektori. Prodhuesit e bojërave dhe veshjeve u përpoqën të tërheqin operimet e brendshme duke u përpjekur të reduktonin aktivitetet e kontraktuara. Duke vepruar kështu, ata rifituan kontroll edhe më të mirë mbi tërë procesin e prodhimit dhe rritën pjesën e vlerës së shtuar të realizuar brenda kompanive. Aktivitete të tilla gjithashtu kanë reduktuar varësinë nga furnitorët³.

¹ The Farnsworth Group, Market Watch: Trends in the Paint and Coatings Industry, 2021, <https://www.thefarnsworthgroup.com/blog/trends-paint-and-coatings-industry>

² Transparency Market Research, 2021, Global Detergents Market, <https://www.transparencymarketresearch.com/detergents-market.html>

³ Meta Arh, Mateja Novak, Michael McManus, Mateja Dermastia, 2021, Value Chain Resilience in the Time of COVID 19 with Focus in Foo and Natural Cosmetics, DOI:10.13140/RG.2.2.27618.45760

Përmirësimi i qëndrueshmërisë

Prodhimi i qëndrueshëm konsiderohet si një trend kryesor që ndikon në mbarë industrinë e përpunimit kimik. Rrjedhimisht, qëndrueshmëria viteve të fundit është bërë një tendencë kryesore për prodhimin e bojërave dhe veshjeve. Ky trend ka çuar në uljen e konsumit të energjisë dhe lëndëve të para për shkak të efikasitetit më të lartë të procesit dhe rritjes së përdorimit të materialeve të ripërtëritshme. Një fokus i rëndësishëm iu kushtua reduktimit të Përbërjeve Organike të Avullueshme (VOC)⁴. Një shtytje globale rregullatore ndikoi te prodhuesit e bojërave dhe veshjeve për të reduktuar VOC-të, të cilat janë të rëndësishme për jetëgjatësinë e lartë dhe për përmirësimin e qëndrueshmërisë, por gjithashtu ndikojnë negativisht në cilësinë e ajrit dhe mirëqenien njerëzore. Rregulloret më të ashpra dhe rritja e kërkesës së konsumatorëve ndikuan fuqishëm në zhvendosjen drejt produkteve alternative dhe me përmbajtje të ulët të VOC-ve dhe kufizimeve në proceset e prodhimit duke përdorur produkte me VOC. Përdorimi i përbërësve me bazë bimë dhe kalimi nga shtresat me bazë tretësi në ato me bazë uji përbën reagim të dedikuar të industrisë, gjë që rezultoi në reduktimin e gjurmës së karbonit duke zëvendësuar naftën e papërpunuar.

Rritja e përdorimit të përbërësve natyralë është me rëndësi të madhe edhe për sektorin e sapunëve, detergjentit dhe kozmetikës shtëpiake, por ka marrë një rëndësi të shtuar gjatë viteve të fundit. Konsumatorët privat preferojnë gjithnjë e më shumë përbërësit natyral mbi ata artificial.

Prodhimi i gjelbër

Trendet e tjera të rëndësishme janë Marrëveshja e Gjelbër Evropiane⁵ dhe përmirësimi i kërkesave të klientëve për prodhimin mjedisor. Industria duhet të reagojë si duhet ndaj minimizimit të mbetjeve, përmirësimit të efikasitetit të procesit dhe rritjes së përdorimit të materialeve dhe energjisë së ripërtëritshme. Por gjithashtu, aplikimi i veshjeve më të holla për të zvogëluar sasinë e veshjeve është një tjetër reagim i industrisë ndaj prodhimit miqësor ndaj mjedisit. Teknologjitë e reja të veshjeve, si teknologjitë e rikuperimit të produktit (pigging) ose veshjet me pluhur, janë të lidhura me trendet në zhvillim⁶. Solucionet për pigging, ose për rikuperimin e produktit të lëngshëm, janë të përshtatshme për bojërat dhe veshjet me bazë uji dhe tretësi. Ato mundësojnë një sërë përfitimesh të prekshme, nga minimizimi i mbetjeve e deri tek rritja e rendimentit dhe kursimit të kostos.

Dixhitalizimi

Dixhitalizimi nuk është diçka e re për shumicën e ndërmarrjeve që operojnë në sektorët e përpunimit kimik. Sidomos për faktin se shumica e ndërmarrjeve në Evropë dhe SHBA kanë zbatuar tashmë zgjidhje dixhitale dhe, kështu, tani fokusohen më shumë në përmirësimet më të mëtejshme të operacioneve. Megjithatë, mund të shihet se dixhitalizimi përdoret gjithnjë e më shumë për të përmirësuar qëndrueshmërinë e prodhimit dhe funksionimin në nivel firme⁷. Aplikacionet kryesore të reja dixhitale do të përdoren për të reduktuar përdorimin e burimeve, ndotjen, konsumin dhe humbjen e energjisë. Gjithashtu, do të krijojnë kërkesë për një ekonomi qarkore të mundësuar nga teknologjitë dixhitale si Inteligjenca Artificiale (AI) ose Interneti i

4 FORTUNE BUSINESS, 2022, Paints and Coating Market Forecast 2022 – 2029, <https://www.fortunebusinessinsights.com/industry-reports/paints-and-coatings-market-101947>

5 <https://errin.eu/tags/european-green-deal>

6 The Farnsworth Group, Market Watch: Trends in the Paint and Coatings Industry, 2021, <https://www.thefarnsworthgroup.com/blog/trends-paint-and-coatings-industry>

7 Gulf Petrochemical & Chemicals Association, 2022, <https://www.gpca.org.ae/2022/02/27/digitalization-in-the-chemical-industry-what-next/>

Gjërave. Sistemet për konsum të qëndrueshëm të energjisë dhe karburantit, sistemet e dispeçimit për logjistikë eficiente dhe zgjidhje autonome që mundësojnë reduktimin e konsumit të energjisë janë disa që janë krijuar aktualisht ose që janë duke u zbatuar në industrinë e përpunimit kimik.⁸

Përdorimi i mjeteve dixhitale për të kuptuar më mirë të dhënat në nivel firme, të prodhuara gjatë prodhimit të produkteve kimike, është një tjetër trend i rëndësishëm. Për shkak të automatizimit të lartë të proceseve të prodhimit, janë prodhuar shumë të dhëna, por deri më tani nuk janë përdorur si duhet. Përdorimi i AI dhe mësimit të makinerisë mund të ndihmojë në analizimin e grupeve të mëdha të të dhënave të strukturuar dhe të pa-strukturuar. Zgjidhjet e menaxhimit të njohurive të fuqizuara nga AI mund të ndihmojnë kompanitë të rrisin efikasitetin e nxënies dhe ndarjes së njohurive midis ekipeve dhe departamenteve⁹.

Transparenca dhe gjurmueshmëria

Për sa i përket tregut të kozmetikës, konsumatorët privatë janë më të interesuar të mësojnë më shumë për vetë produktet, origjinën e tyre, si janë produkte dhe deri në çfarë mase përmbushen kriteret e qëndrueshmërisë, sociale dhe mjedisore. Kështu, transparenca dhe gjurmueshmëria fituan rëndësi të shtuar. Mjete të reja dixhitale¹⁰ndihmojnë prodhuesin për të dhënë informacione të tilla. Kompanitë që kanë sukses në demonstrimin e transparencës së duhur duhet të fitojnë forma të reja të përparësisë konkurruese, që do të thotë se çmimi dhe cilësia nuk janë më përparësia kryesore konkurruese. Raporti më i fundit i Harvard Business Review¹¹ konfirmon se konsumatorët janë të gatshëm të paguajnë deri në 10% më shumë për produkte nga kompanitë transparente.

⁸ Deloitte, 2022, the Future of Digitalization in the Chemical Industry, <https://www2.deloitte.com/us/en/pages/energy-and-resources/articles/future-of-digitalization-in-the-chemical-industry.html>

⁹ Gulf Petrochemical & Chemicals Association, 2022, <https://www.gpca.org.ae/2022/02/27/digitalization-in-the-chemical-industry-what-next/>

¹⁰ sikur mjeti digjital phy2app për përmirësim të transparencës, <https://www.phy2app.com/transparency>

¹¹ Ryan w. Buell, 2019, Operational Transparency, Harvard Business Review

3. Ilustrim i industrisë së Kosovës

Mungesa e të dhënave në nivel firme dhe, deri diku, në nivel të industrisë, si dhe niveli i informalitetit në ekonomi - i vlerësuar si në prodhim ashtu edhe në punësim - e bën të vështirë vlerësimin e saktë të madhësisë dhe performancës së përgjithshme të sektorëve të përpunimit kimik në Kosovë. Krahas të dhënave primare të mbledhura nëpërmjet një studimi në shkallë të vogël, ky studim përdor të dhëna të tjera ekzistuese të disponueshme publikisht (ndonëse të pakta) për sektorin kimik, për të vlerësuar trendet e sektorit dhe për të siguruar një përafrim të situatës së përgjithshme të sektorit. Burimet kryesore të të dhënave që shqyrton ky studim përfshijnë Administratën Tatimore të Kosovës (ATK), MINT dhe Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës (ARBK).

Bazuar në të dhënat e outputeve të ofruara nga ATK, ka dëshmi të qarta të një trendi gjithnjë në rritje sa i përket sektorit kimik. Numri i përgjithshëm i bizneseve aktive ka qenë 293 sosh në vitin 2021, ndërsa qarkullimi i sektorit në tregun formal në atë vit ka arritur pothuajse në EUR 55 milionë, që është një rritje prej 14% krahasuar me vitin e pandemisë 2020, ose një rritje prej 34% krahasuar me vitin 2017 (Tabela 2). Përveç kësaj, numri i kompanive aktive është rritur gjithashtu me kalimin e kohës; mesatarisht, numri i firmave është rritur me 12% gjatë kësaj periudhe (2017 – 2021). Gjithashtu, të dhënat tregojnë se niveli i punësimit ka ndjekur gjerësisht trendin e prodhimit. Kjo sugjeron një përmirësim të sektorit me një diferencë intensive dhe ekstensive; punësimi në vitin 2021 është rritur për 6.5% krahasuar me vitin paraardhës, ose një rritje mesatare prej 5% gjatë këtij harku pesëvjeçar. Informacione të tilla janë të një rëndësie thelbësore për vetë sektorin privat, investitorët potencial, politikëbërësit dhe akterë të tjerë në Kosovë që mbështesin zhvillimin e sektorit privat. Megjithatë, duhet theksuar se firmat tregtare që operojnë në këtë sektor nuk janë marrë në konsideratë në kuadër të Studimit të Hartëzimit të Zinxhirit të Vlerës.

Tabela 2. Madhësia e Sektorit Kimik në Kosovë (2017-2021)¹²

Treguesi	2021	2020	2019	2018	2017
Numri i kompanive aktive	293	262	225	201	178
Numri i punonjësve	979	915	868	814	792
Qarkullimi total (EUR)	55.268.169	47.518.517	44.615.559	41.157.104	36.,685.119

Burimi: Administrata Tatimore e Kosovës

¹² Nën-sektorët e marrë parasysh në këtë studim. Tregtarët që operojnë në sektorin e kimikateve nuk janë marrë parasysh

Profili i Kompanive të Sektorit

Të dhënat e paraqitura në Tabelën 2 tregojnë tendencën rritëse për sa i përket madhësisë së sektorit kimik gjatë viteve të fundit. Ndërsa numri i bizneseve u rrit për rreth 70% nga viti 2017 në vitin 2021, punësimi u rrit vetëm për 24%. Arsyeja prapa kësaj qëndron se janë shfaqur një pjesë e konsiderueshme e kompanive të reja/biznese të reja, të cilat akoma janë në një fazë shumë embrionale.

Bazuar në dëshmitë e ofruara nga ATK-ja, numri i firmave aktuale aktive është më i vogël se ato të regjistruara tashmë dhe kanë statusin “aktive” në regjistrin e bizneseve.¹³ Nga ana tjetër, të dhënat e ARBK-së tregojnë se aktualisht janë 511 firma të regjistruara, ndërsa 43 firma janë mbyllur. Kjo mospërputhje sugjeron se ka një numër të madh firmash në sektor që janë joaktive ose që kanë dalë përkohësisht nga tregu.

Tabela 3. Struktura industriale e firmave në sektorin kimik

Divizioni (Sektori)	Grupi (Industria)	Klasa (Nën-sektori industrial)
Prodhimi i kimikateve dhe produkteve kimike	Prodhimi i kimikateve bazë, plehrave dhe komponimeve të azotit, plastikës dhe gomës sintetike në forma primare	Prodhimi i gazrave industriale
		Prodhimi i ngjyruësve dhe pigmenteve
		Prodhimi i produkteve të tjera kimike me bazë inorganike
		Prodhimi i produkteve të tjera kimike me bazë organik
		Prodhimi i plehrave dhe komponimeve të azotit
		Prodhimi i plastikës në forma primare
		Prodhimi i gomës sintetike në forma primare
	Prodhimi i pesticideve dhe produkteve të tjera agrokimike	Prodhimi i pesticideve dhe produkteve të tjera agrokimike
	Prodhimi i bojërave, llaqeve dhe veshjeve të ngjashme, ngjyrës për printim dhe mastikës	Prodhimi i bojërave, llaqeve dhe veshjeve të ngjashme, ngjyrave të printimit dhe mastikës
	Prodhimi i sapunit dhe detergjenteve, preparateve për pastrim dhe lustrim, parfume dhe preparate tualeti	Prodhimi i sapunit, detergjenteve dhe produkteve të pastrimit, si dhe preparateve për shkëlqim
		Prodhimi i parfumeve dhe preparateve të tualetit
	Prodhimi i produkteve të tjera kimike	Prodhimi i eksplozivëve
		Prodhimi i ngjitësve
		Prodhimi i vajrave esenciale
		Prodhimi i produkteve të tjera kimike p.k.t
	Prodhimi i fibrave sintetike dhe artificiale	Prodhimi i fibrave sintetike dhe artificiale

Burimi: ARBK, 2022

¹³ Të dhënat e marra nga regjistri i bizneseve të publikuara nga Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës <https://arbk.rks-gov.net/page.aspx?id=1,42>


Gjashtë grupet kryesore të industrisë përbëjnë industrinë kimike në Kosovë. Ky kategorizim buron nga ndarja në nomenklaturën NACE ('Nomenclature Statistique des Activités Économiques dans la Communauté Européenne'), përkatësisht, prodhimi i kimikateve dhe produkteve kimike (Tabela 3). Kategoria e parë dhe më e madhe, prodhimi i kimikateve bazë, plehrave dhe komponimeve azotike, plastikës dhe gomës sintetike në forma primare, përfshin kryesisht kompanitë (117 firma aktive deri në vitin 2021) e prodhimit të ngjyruësve dhe pigmenteve, si dhe në prodhimin e plastikës në forma primare (72% e totalit të firmave në këtë kategori). Në grupin e dytë, atë të prodhimit të pesticideve dhe produkteve të tjera agrokimike, janë vetëm 8 biznese të regjistruara, por asnjëri prej tyre nuk ka qenë aktiv në fund të vitit fiskal 2021. Aktualisht janë 40 kompani që janë aktive në prodhimin e bojërave, llaqeve dhe veshjeve të ngjashme, ngjyrave të printimit dhe mastikës. Një nga industritë në zhvillim në sektorin e kimikateve është prodhimi i sapunëve dhe detergjenteve, preparateve të pastrimit dhe shkëlqimit, parfumeve dhe preparateve të tualetit. Në vitin 2021, në mbarë Kosovën kanë qenë 101 biznese aktive që prodhonin sapunë, detergjente, produkte pastrimi dhe parfume, kryesisht për tregun vendor. Një numër relativisht i vogël i firmave aktive (30) janë të angazhuara në prodhimin e produkteve të tjera kimike. Së fundi, në Kosovë ekzistojnë vetëm pesë kompani të angazhuara në prodhimin e fibrave sintetike dhe artificiale.

3.1 Trendet e Tregtisë në Sektorin Kimik të Kosovës

Të dhënat e paraqitura në Figurën 1 dhe në këtë seksion bazohen në të dhënat e Doganës së Kosovës. Eksportet e produkteve kimike të Kosovës kanë shënuar rritje konstante gjatë pesë viteve të fundit. Një rritje më e shprehur vërehet në vitin 2020, e nxitur kryesisht nga rritja e kërkesës për produkte të lidhura me higjienën, duke rezultuar në rritje të lartë nominale prej rreth 137%, por një rritje relativisht më e vogël në eksportet reale ose peshën neto të të gjitha produkteve të eksportuara me rreth 51%.


Siç është paraqitur në Figurën 1, nga rreth EUR 3,7 milionë në vitin 2017, eksportet e përgjithshme kimike kanë arritur në rreth EUR 16,8 milionë në vitin 2021. Nga ana tjetër, importet e produkteve kimike kanë shënuar rritje më të ngadaltë, nga rreth EUR 205 milionë në vitin 2017, në rreth EUR 365 milionë në vitin 2021.

Siç mund të shihet nga trendet e eksporteve të paraqitura në Figurën 2, është e qartë se çmimet kanë trend të rritjes, por ritmi i rritjes së eksporteve sugjeron edhe një perspektivë pozitive të eksportit për prodhuesit kosovarë. Çmimet e importit, mesatarisht, kanë shënuar rritje më të theksuar në krahasim me çmimet e eksportit, duke sugjeruar rritjen e konkurrencës së çmimeve të produkteve kimike kosovare në tregun e eksportit.

Figura 1. Vlera vjetore e importeve dhe eksporteve në sektorin kimik të Kosovës, 2017-2021

Burimi: Llogaritja e autorit, të dhënat nga Dogana e Kosovës


Duke parë trendin e rritjes (Figura 2), eksportet kimike tregojnë një perspektivë premtuese, me një rritje vjetore të normës së rritjes së eksporteve që nga viti 2017, me një mesatare prej 52% gjatë tre viteve të fundit. Një trend më i ngadalshëm i rritjes vërehet tek importet, me një rritje mesatare prej rreth 16%. Rritje e papritur është shënuar në vitin 2020 për eksportet, ndërsa rritje më e lartë e importeve është shënuar në vitin 2021. Këto ndryshime ndikohen kryesisht nga ndryshimet në zinxhirin e furnizimit global, për shkak të efekteve të pandemisë COVID-19 dhe luftës në Ukrainë.

Figura 2. Normat vjetore të rritjes së importeve dhe eksporteve të sektorit kimik të Kosovës, 2018-2021

Burimi: Llogaritja e autorit, të dhënat nga Dogana e Kosovës

Në pesë vitet e fundit, raporti i mbulimit të eksporteve kimike ndaj importeve ka qenë midis 2% dhe 6%, por me një trend dukshëm në rritje të eksporteve gjatë periudhës 2018-2021 (Figura 3). Për sa i përket bilanci tregtar të sektorit kimik, eksportet kanë shënuar trend rritës, nga 1% në vitet 2017-2018, në mes 2% dhe 4% të totalit të eksporteve gjatë viteve 2019-2021. Duke parë trendin e importeve, trendi i importeve kimike ka qenë relativisht i qëndrueshëm ndër vite, që përbën rreth 7%-8% të importeve të përgjithshme kosovare.

Figura 3. Sektori kimik i Kosovës, trendet e tregut, 2017-2021



Burimi: Llogaritja e autorit, të dhënat nga Dogana e Kosovës


Për të siguruar një dinamikë më të qartë tregtare të sektorit kimik janë analizuar nën-sektorët kryesorë. Nën-sektorët janë përcaktuar në bazë të kodeve të produkteve të përdorura nga Dogana e Kosovës. Këto kode janë të harmonizuara me Statistikat e Tregtisë Ndërkombëtare të Kombeve të Bashkuara, Sistemet e Harmonizuara të Përshkrimit dhe Kodimit të Mallrave (HS). Analiza është bërë në bazë të nën-sektorëve të mëposhtëm:

- Plehra, ekstrakte dhe polimere (kryesisht bojëra dhe veshje)
- Sapunë, vajra esenciale dhe rrëshira
- Produkte të tjera kimike

Në Figurën 4 më poshtë janë paraqitur trendet e eksporteve sipas nën-sektorëve midis viteve 2017-2021. Rritja e vazhdueshme tregohet nga dy kategoritë e para të produkteve: kimikatet inorganike, organike, plehra, ekstrakte dhe polimere, si dhe sapunë, vajra esenciale dhe rrëshira.

Figura 4. Eksportet e sektorit kimik të Kosovës, sipas nën-sektorëve, 2017-2021

■ 2017 ■ 2018 ■ 2019 ■ 2020 ■ 2021




Burimi: Llogaritjet e autorit, grupi i të dhënave nga Dogana e Kosovës

Kimikatet inorganike/organike, plehrat, ekstraktet dhe polimeret (kryesisht bojërat dhe veshjet) kanë shënuar një trend të vazhdueshëm pozitiv të rritjes së eksportit, nga rreth EUR 2.8 milionë në vitin 2017, duke arritur në rreth EUR 7.6 milionë në vitin 2021 (+171%). Një trend i ngjashëm i rritjes vërehet tek sapunët, detergjentet, vajrat esenciale dhe rrëshirat, duke u rritur nga rreth EUR 688 mijë në vitin 2017, në rreth EUR 8.5 milionë në vitin 2021 (mbi 12 herë), por kulmi i rritjes është shënuar në vitin 2020 (duke arritur në mbi EUR 10 milionë). Produktet e tjera kimike përfaqësojnë një nën-sektor gjithashtu me një normë të lartë të rritjes së eksporteve (rreth 100%), por me një peshë shumë të vogël në eksportet e përgjithshme, ose një shumë të përgjithshme prej rreth EUR 0.5 milionë në vitin 2021. Këto observime tregojnë se produktet kimike të prodhuara në Kosovë kanë një kërkesë në rritje në tregjet e eksportit, e nxitur edhe nga rritja e kërkesës për produkte të lidhura me higjienën për shkak të situatës së shkaktuar nga pandemia COVID-19.

Importet kimike në përgjithësi shfaqin një trend rritjeje relativisht të ngadaltë. Produktet kryesore të importuara që përbëjnë rreth 58% të të gjithë importeve kimike përfshijnë kimikatet inorganike dhe organike, plehrat, ekstraktet dhe polimeret.

Figura 5. Nivelet e produktivititetit, ekonomia totale



3.2 Analiza e produktivititetit dhe konkurrueshmërisë me homologët e përzgjedhur

Analiza e sektorit kimik në Kosovë në një kontekst rajonal ofron një pasqyrë më të mirë mbi produktivitetin dhe konkurrencën e industrisë. Prodhuesit kosovarë të kimikateve kryesisht konkurrojnë me kompani të ngjashme në rajon, ku bizneset në Maqedoninë e Veriut dhe në Serbi janë më konkurrueset.

Kosova ka shënuar një normë të rritjes së vlerës së shtuar për kokë banori prej rreth 3% për periudhën 2009 – 2017, ngjashëm me vendet e tjera të rajonit¹⁴. Përveç kësaj, siç tregohet në figurën 5, Kosova ka pasur një trend pozitiv të përmirësimit të produktivititetit në krahasim me shumicën e vendeve të rajonit, me përjashtim të Rumanisë që ka tejkaluar të gjitha vendet e tjera dhe Malit të Zi që tregon një trend të ngjashëm me Kosovën. Përkundër trendit mjaft pozitiv sa i përket produktivititetit, dhe performancës së mirë krahasuar me shumicën e vendeve të rajonit, Kosova qëndron prapa shumicës së tyre sa i përket investimeve në kërkime dhe zhvillim që çojnë në inovacion.¹⁵ Kosova gjithashtu ka shkallën më të lartë të papunësisë në rajon, rreth 25%.¹⁶ Meqenëse investimet në inovacion dhe produktivitet janë thelbësore për një performancë të përmirësuar, institucionet përkatëse duhet të hartojnë politika që do të mbështesin një intensitet të rritur të Kërkimit dhe Zhvillimit në sektorin kimik.

¹⁴ Reiter, Oliver; Schwarzhappel, Monika; Stehrer, Robert, 2020, Produktiviteti dhe konkurrueshmëria e vendeve të Ballkanit Perëndimor: Një analizë e bazuar në bazën e të dhënave të produktivititetit të Ballkanit Perëndimor wiiw, Shënime dhe Raporte Politike, Nr. 37, Instituti i Vjenës për Studime Ekonomike Ndërkombëtare (wiiw), Vjenë


¹⁵ OECD, 2022, Indeksi i Politikës së NVM-ve: Ballkani Perëndimor dhe Turqia, 2022.

¹⁶ OECD, 2021, Konkurrueshmëria në Evropën Juglindore, 2021, Një Perspektivë e Politikave, <https://www.oecd-ilibrary.org/sites/66c185f2-en/index.html?itemId=/content/component/66c185f2-en>

Konkurrenca tregtare e sektorit kimik të Kosovës është ilustruar në Figurën 6. Në boshtin horizontal, vlerat përkatëse përfaqësojnë normën mesatare të rritjes së importeve të BE-së ndërmjet viteve 2017-2021, ndërsa vlera përkatëse në boshtin vertikal paraqet normën mesatare të rritjes së eksporteve të Kosovës në periudhën 2017-2021. Çdo nën-sektor kimik përshkruhet nga një flluskë. Rritja mesatare e importeve në tregun e BE-së është më e larta në produktet kimike terciare (p.sh. llojet e ngjitësve) e ndjekur nga kimikatet inorganike dhe organike, plehrat, ekstraktet dhe polimeret, me një normë më të ulët rritjeje në importet e sapunëve, vajrave esenciale dhe rrëshirave.

Siç ilustron diagrami, në të gjithë nën-sektorët, eksportet kimike kanë një normë mesatare rritjeje relativisht të lartë, me ritmet më të larta të eksporteve të sapunëve, vajrave esenciale dhe rrëshirave (me rritje mesatare mbi 100%), të ndjekura nga kimikatet inorganike dhe organike, ekstraktet e plehrave dhe polimeret. Një normë e lartë e rritjes së eksporteve të produkteve kimike mund të sugjerojë një tendencë të shtuar kohëve të fundit të kompanive kimike kosovare për të prodhuar dhe eksportuar produkte me vlerë të shtuar më të lartë. Ritmet e rritjes së eksporteve janë shumë më të larta se ritmi i rritjes së importeve të BE-së, gjë që tregon se produktet kosovare fitojnë pjesë shtesë të tregut. Ky vëzhgim sugjeron një konkurrencë të lartë dhe potencial rritjeje të kësaj industrie, veçanërisht në sektorët e sapunit, detergjenteve dhe kozmetikës.

Figura 6. Rritja e ofertës kombëtare dhe kërkesa ndërkombëtare për kimikate të eksportuara nga Kosova në vitin 2021



Burimi: Llogaritja e autorit, Qendra për Tregti Ndërkombëtare, të dhëna nga Dogana e Kosovës, periudha: 2017 - 2021

Nëse e shikojmë periudhën me të fundit, ndërmjet viteve 2019 – 2021, krahas Kosovës, eksporti i produkteve kimike është rritur ndjeshëm edhe në Maqedoninë e Veriut dhe në Serbi, siç është paraqitur në Figurën 7. Këtu po ashtu shihet se sektori i prodhimit kimik në Kosovë është ende shumë i vogël, në krahasim me disa nga vendet fqinje. Për sa i përket vlerës së eksporteve, Maqedonia e Veriut është vend lider në rajon, e pasuar nga Serbia dhe Bosnja dhe Hercegovina, Shqipëria, Kosova dhe Malin e Zi, që kanë nivele relativisht më të ulëta të eksportit. Megjithatë, siç tregohet në Figurën 8, Kosova është vendi kryesor eksportues për

sa i përket normës mesatare të rritjes gjatë tri viteve të fundit (72%), duke tejkaluar në masë të madhe të gjitha vendet e tjera në rajon, me Maqedoninë e Veriut si performuesin e dytë më të mirë, duke regjistruar një normë mesatare të rritjes prej rreth 29%, dhe Shqipëria si performuesi më i dobët, me një normë mesatare negative të rritjes prej -9%. Megjithatë, ritmet më të larta të rritjes së Kosovës nuk mund të prodhojnë ende rezultate të ndjeshme për shkak të nivelit absolutisht të ulët të krahasueshëm (Figura 7).

Figura 7. Zhvillimi i eksportit të produkteve kimike në rajon ndërmjet vitit 2019 dhe 2021

■ 2019 ■ 2020 ■ 2021





Figura 8. Rritja mesatare e eksportit të produkteve kimike sipas shteteve, ndërmjet vitit 2019 dhe 2021



Burimi: Llogaritja e autorit, Qendra Ndërkombëtare e Tregtisë

4. Harta e palëve të interesuara

Numri i palëve të interesuara në sektorin kimik në Kosovë është relativisht i vogël, sidomos në krahasim me sektorët e tjerë, siç janë: ushqimi dhe pijet, TIK-u apo prodhimi i metaleve. Pavarësisht numrit të kufizuar, roli i këtyre akterëve është thelbësor për zinxhirin e vlerës – dinamikën, trendet dhe zhvillimin përkatës. Në Tabelën e mëposhtme janë paraqitur palët kryesore të interesit që janë të rëndësishëm për zinxhirin e vlerës kimike, të ndarë në tri grupe në bazë të roleve dhe aktivitetit të tyre në zinxhirin e vlerës: palët primare, dytësore dhe terciare të interesit.

Palët kryesore që janë të përfshirë drejtpërdrejt dhe aktivisht në zinxhirin e vlerës kimike paraqiten si palë primare të interesit, ndërsa ata që kanë një marrëdhënie më indirekte janë palë dytësore dhe terciare. Palët primare të interesit përbëhen nga ndërmarrjet e sektorit (mikro, të vogla, të mesme dhe të mëdha) universitetet dhe institucionet e kërkimit dhe zhvillimit. Palët dytësore të interesit përbëhen nga institucionet (si ministritë dhe agjencitë) dhe shoqatat anëtare të sektorit të biznesit, të cilat kanë një marrëdhënie më indirekte me sektorin, megjithëse janë vendimtare për mjedisin e biznesit dhe zhvillimin e këtij sektorit. Së fundi, palët terciare të interesit janë agjencitë donatore ndërkombëtare që nuk kanë fuqi vendimmarrëse dhe që nuk përfitojnë nga sektori, por kanë objektiv dhe rol të rëndësishëm për të mbështetur zhvillimin e zinxhirit të vlerës. Tabela 4 paraqet akterët kryesorë të identifikuar për sektorin kimik në Kosovë, rolin, interesin, rëndësinë dhe ndikimin e tyre, si dhe ndërlidhjen e tyre dinamike.

Tabela 4: Akterët kryesor në zinxhirin e vlerës së përpunimit kimik

Nr.	Palët e intere- suara (grupet)	Interesi	Rëndësia ¹⁷	Ndikimi ¹⁸	Shembujt
Palët primare të interesit					
1	NMVM-të	NMVM-të janë subjektet kryesore dhe nxitësit e ndryshimit për sektorin kimik. Pavarësisht madhësisë relativisht të kufizuar të sektorit, si dhe mungesës së funksioneve dhe politikave mbështetëse për sektorin, NMVM-të e sektorit kimik vazhdojnë të rriten dhe të rrisin diversitetin dhe cilësinë e ofertës së tyre. NMVM-të nuk janë në gjendje të arrijnë potencialin e tyre të rritjes për shkak të sfidave të shumta dhe mungesës së mbështetjes	4	4	
2	Jo-NMVM-të	Pothuajse të gjitha kompanitë e sektorit kimik janë NMVM, ndërsa sektori numëron shumë pak ndërmarrje "më të mëdha" të cilat mund të kategorizohen si prodhues dominues.	4	3	
3	Universitetet dhe Institucionet e Kërkimit dhe Zhvillimit	Universitetet dhe institucionet e K dhe ZH supozohet të ofrojnë të diplomuar të trajnuar mirë, si dhe të ofrojnë një bazë njohurish për nxitjen e inovacionit. Megjithatë, niveli aktual i njohurive dhe ekspertizës në fusha të tilla si teknologjia dhe kimia janë të pakënaqshme dhe të kufizuara drejt rritjes. Përmirësimi i përgjithshëm i ofrimit të shërbimeve dhe ofrimit të aftësive është esencial në përmirësimin e cilësisë së produktit, inovacionit dhe diversitetit.	2	1	Universitetet publike dhe private

¹⁷ Rëndësia për suksesin e projektit; deri në çfarë mase projekti (zhvillimi i kornizës së politikave të grupimeve) i jep prioritet përbushjes së nevojave dhe interesave të tyre 4 = rëndësi shumë të lartë, 3 = rëndësi të lartë, 2 = rëndësi të ulët, 1 = shumë të ulët ose aspak i rëndësishëm

¹⁸ Ndikimi se në çfarë mase palët kryesore të interesit kontribuojnë në suksesin ose dështimin e një projekti; 4 = ndikim shumë të fortë, mund të sjellë sukses ose dështim të projektit; 3 = ndikim të fortë, mund të mbështesë ose pengojë ndjeshëm projektin, 2 = ndikim mesatar: mund të lehtësojë ose pengojë pak suksesin e projektit; 1 = ndikim të ulët ose aspak

Nr.	Palët e intere-suara (grupet)	Interesi	Rëndësia ¹⁷	Ndikimi ¹⁸	Shembujt
Palët dytësore të interesit					
4	Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT)	MINT është përgjegjës për të mbështetur sektorin privat duke ofruar kushte të përshatshme kornizë për rritje dhe konkurrencë. Sektori kimik merr relativisht më pak ose aspak mbështetje nga Ministria, veçanërisht në krahasim me sektorët e tjerë. Me mbështetjen dhe politikat adekuate, MINT mund të ndihmojë kompanitë e sektorit të konkurrojnë më mirë në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar dhe të nxisin investimet në këtë sektor.	4	4	
5	Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturrës (MMPHI)	MMPHI është institucioni përgjegjës për çështjet mjedisore dhe dhënien e lejeve përkatëse për bizneset që operojnë në sektorin kimik dhe sektorë të tjerë, aktivitetet e të cilëve mund të kenë efekte afatgjata në mjedis (ndotje, kontaminim, etj.).	3	4	
6	Ministritë e tjera	Ministritë e tjera mund të mbështesin në mënyrë indirekte zhvillimin e zinxhirit të vlerës së sektorit kimik në Kosovë. Për shembull, nëpërmjet përmirësimit të programeve të arsimit dhe trajnimit dhe mbështetjes së infrastrukturës K dhe ZH. Deri më sot, mbështetja e tillë është mjaft e pakët, por me potencial për sektorin.	3	23	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
7	Iniciativat klaster ose Organizatat e tjera të Anëtarësimit të Biznesit (OAB)	Asociacionet e mëdha të nivelit kombëtar, si Klubi i Prodhuesve të Kosovës (KPK) ose Oda Ekonomike e Kosovës (OEK), përbëhen nga ndërmarrjet kryesore. Sektori kimik është kryesisht i nën-përfaqësuar në të dyja dhomat. Megjithatë, KPK paraqet një shembull mjaft pozitiv të një historie të suksesshme të avokimit në dobi të kompanive të sektorit privat, ndërsa OEK në përgjithësi tregon motivim më të ulët.	2	2	KPK OEK


Nr.	Palët e intere- suara (grupet)	Interesi	Rëndësia ¹⁷	Ndikimi ¹⁸	Shembujt
8	Agjencitë për mbështetjen e investimeve	KIESA – është mandatuar të promovoj dhe mbështet investimet dhe investitorët potencialë të interesuar për t’u angazhuar në Republikën e Kosovës. Roli i KIESA është shumë i kufizuar në sektorin kimik. Megjithatë, KIESA është aktive në promovim, veçanërisht përmes organizimit të panaireve për sektorë të tjerë, të cilët lehtësisht mund të përsëriten në sektorin kimik. Në mënyrë të ngjashme, për ndërmarrjet e tjera të sektorit, KIESA ofron një gamë të gjerë shërbimesh për investitorët, duke filluar nga mbështetja para-investimit deri tek shërbimet e kujdesit të mëtejshëm.	2	2	KIESA
9	Shoqatat e Sektorëve	Sektori kimik është nga të paktët sektorë privatë që nuk organizohet në një shoqatë sektori. Një iniciativë për rrjetëzimin dhe bashkëpunimin e ndërmarrjeve sektoriale mund të jetë e dobishme, veçanërisht në drejtim të avokimit dhe lobimit për tërheqjen e mbështetjes institucionale për sektorin.	NA	NA	
Palët terciare të interesit					
10	Partnerët ndërkombëtarë dhe institucionet e BE-së	Ka shumë donatorë ndërkombëtarë dhe organizata zbatuese, përkatësisht, aktive në Kosovë që ofrojnë mbështetje për entitete të ndryshme të sektorit privat dhe publik në sektorin kimik. Ata të gjithë synojnë të përmirësojnë kushtet kornizë për rritje, qëndrueshmëri dhe krijimin e vendeve të punës.	3	3	GIZ USAID

5 Analiza e zinxhirit të vlerës

5.1 Harta e zinxhirit të vlerës së sektorit

- 1. Sektori i përpunimit kimik është një sektor i vogël, por që është në rritje e sipër dhe me potencial të lartë eksporti** - Fakti që kompanitë kosovare të përpunimit kimik kanë mundur të përmirësojnë ndjeshëm sasinë e mallrave të eksportuara gjatë viteve të fundit, dëshmon rritjen e konkurrencës së këtij sektori. Eksportet e tilla tregojnë se kompanitë vendore janë në gjendje të depërtojnë në tregjet e huaja. Çrregullimet e tanishme të zinxhirit të furnizimit dhe trendi për ngritjen e afërt me gjasë do të mbajë kërkesën e lartë për produkte të tilla të prodhuara në Kosovë dhe në vendet fqinje.
- 2. Sektori i ndërtimit dhe kozmetikës do të shfaqë ritme të larta rritjeje në terma afatmesëm** - Kompanitë kosovare të përpunimit kimik janë furnizues për kompanitë e ndërtimit dhe prodhuesit e kozmetikës. Sipas parashikimeve aktuale të tregut, të dy sektorët pritet të rriten më tej. Normat pozitive të rritjes për këta sektorë do ta mbajnë kërkesën për ofertë kosovare në nivel të lartë.
- 3. Trendi për prodhim të qëndrueshëm mund të ofrojë mundësi të reja për furnitorët kosovarë** - Trendet aktuale globale për përmirësimin e qëndrueshmërisë i detyron furnitorët dhe blerësit të rishqyrtojnë burimin e lëndëve të para të përdorura dhe mënyrën se si prodhohen produktet. Zëvendësimi i lëndëve të para me bazë fosile, me p. sh. bazë uji për bojëra dhe veshje të fasadave jo vetëm që do të kontribuojë në përmirësimin e qëndrueshmërisë, por gjithashtu do të zvogëlojë varësinë nga lëndët e para fosile nga jashtë Kosovës. E njëjta gjë vlen edhe për produktet e banjës dhe dushit. Nga njëra anë, klientët kërkojnë më tej përbërës natyralë. Megjithatë, nga ana tjetër, prodhuesit kosovarë të kozmetikës mund të përdorin materiale të lëndëve të para me burime vendore dhe të zvogëlojnë varësinë nga furnizimi me lëndë të parë të huaj. Kështu, ky trend, i cili shpesh konsiderohet si sfidë, mund të kthehet në një përparësi konkurruese për kompanitë kosovare të përpunimit kimik.
- 4. Prodhimi me kontratë si mundësi e re biznesi për prodhuesit vendorë** - Prodhuesit kosovarë të kimikateve janë relativisht të vegjël, por fleksibël. Meqenëse ekonomitë e shkallës nuk janë zhvilluar ende në nivel të firmave individuale, ekziston mundësia e rritjes së bashkëpunimit midis prodhuesve vendorë, si për shembull lidhja e kontratave të prodhimit të përbashkët ose nën-kontraktimi i një pjese të prodhimit të kontraktuar. Etiketimi privat është një nga qasjet për të rritur shfrytëzimin e kapaciteteve dhe fitimeve aktuale prodhuese. Trendi në rritje i eksporteve tregon se ka potencial për etiketim privat me prodhues/

blerës ndërkombëtarë, gjë që do të kontribuonte më tej në zhvillimin e njohurive teknike për prodhimin dhe qasje në rrjetet më të gjera të tregut.

7.2 Barrierat

Në pasazhet e mëposhtme janë listuar barrierat dhe kufizimet kryesore të cilat pengojnë rritjen e mëtejshme të sektorit ose që mund të ndikojnë negativisht në konkurrencën e firmave në sektorin kimik. Adresimi i këtyre kufizimeve me ndërhyrje dhe politika të përshtatshme mund ta çojë sektorin drejt një trajektoreje të jashtëzakonshme rritjeje.

- 1. Konkurrueshmëria e dobët e produktit** - Përkundër kënaqëshmërisë së vetë-aprovuar nga ndërmarrjet e sektorit mbi cilësinë e produktit, cilësia e produkteve në sektorin kimik, në rastin më të mirë, është e pasigurt. Shumë produkte, duke përfshirë kategoritë e produkteve si bojërat, veshjet, shampionët, detergjentet, etj., prezantohen dhe tregtohen si marka ndërkombëtare "në vijim". Disa nga këto produkte madje mund të konsiderohen si produkte të kopjuara. Kjo nënkupton dhe paraqitet si e zbuluar nga anketa se çmimi është një nga aspektet konkurruese për produktet vendore në sektorin kimik. Megjithatë, konkurrimi në çmim është gjithmonë sfidë dhe barrierë specifike për trajtimin e segmenteve të tregut me vlerë të lartë të shtuar. Prodhuesit vendorë të kozmetikës shpesh përmbushin mjaftueshëm kërkesat e cilësisë, por për shkak të pozicionit të tyre të dobët në treg, ata nuk janë në gjendje të arrijnë çmimet e tregut të konkurrentëve.
- 2. Sektori i përpunimit kimik dominohet nga ndërmarrjet mikro dhe të vogla** - Shumica dërrmuese e bizneseve kosovare që operojnë në këtë sektor janë firma mikro dhe të vogla me kapacitete shumë të kufizuara prodhuese, teknike dhe financiare. Kjo e bën të vështirë rritjen, p.sh. duke investuar në kapacitete më të larta ose makineri, pajisje apo teknologji të reja të procesit, të nevojshme për t'u përgjigjur si duhet trendeve të reja të tregut dhe për të kaluar në produkte me vlerë më të lartë të shtuar. Ndërmarrjet e tilla mikro dhe të vogla gjithmonë kanë probleme me qasjen në mjetet e nevojshme financiare, veçanërisht pasi në Kosovë mungojnë instrumentet e duhura financiare që synojnë të mbështesin rritjen e firmave të vogla. Për më tepër, dalja në arenën ndërkombëtare bëhet sfiduese për ndërmarrje të tilla, pasi mungojnë përvojat, kompetencat dhe kapacitetet përkatëse.
- 3. Qasje e siguruar në lëndën e parë** - Vështirësitë e sigurimit të lëndës së parë, të rënduara nga pandemia COVID-19 dhe kriza e fundit në Ukrainë, e cila evoluoi në luftë ekonomike, po dëmtojnë sistematikisht potencialin e sektorit kimik në Kosovë, pasi që pothuajse të gjitha llojet e lëndëve të para po importohen (pavarësisht lëndëve të para me burime vendore për produkte kozmetike). Presionet e fundit inflacioniste sapo kanë përkeqësuar pozicionin e prodhuesve vendorë në sektorin kimik, kundrejt konkurrencës së importeve. Përveç kësaj, politika ekzistuese fiskale për industrinë vendore, përkatësisht akciza në lëndët e para, po i ngarkon një barrë shtesë konkurrencës së sektorit kimik në Kosovë.
- 4. Sektori është krahasimisht i paorganizuar dhe ka lidhje të dobëta me subjektet ekzistuese mbështetëse** - Një nga barrierat më urgjente që firmat theksuan në sektorin e përpunimit kimik në Kosovë ka qenë mungesa e qasjes në trupat mbështetëse, d.m.th., shoqatat e sektorit, akademinë, laboratorët e certifikuar dhe shërbimet e tjera mbështetëse që do të nxisnin inovacionin, eksportet dhe rritjen e sektorit. Shumica e të intervistuarve kanë shprehur gjithashtu interesin e tyre për rritjen e rrjeteve dhe shkëmbimit të përvojave. Përveç kësaj, sektori është kryesisht i çorganizuar, pasi mungojnë OAB-të ose

shoqatat specifike të sektorit. Ky fakt i pengon kompanitë të ndërmarrin veprime të përbashkëta kundër barrierave ekzistuese ose të flasin me një zë.


5. **Qasje e kufizuar në mbështetjen dhe financat publike** - Sektori kimik në Kosovë dominohet nga firmat mikro dhe të vogla, gjë që e bën atë shumë jo tërheqës për investitorët e huaj. Skemat ekzistuese të mbështetjes publike janë horizontale (me përjashtim të sektorit të bujqësisë) me burime shumë të kufizuara dhe jo të përshtatura për nevojat specifike të sektorit. Për më tepër, shumica e skemave të mbështetjes financiare publike ose janë të kufizuara ose favorizojnë eksportuesit ekzistues, të cilët potencialisht krijojnë «çrregullime të tregut» në kurriz të jo-eksportuesve që fokusohen vetëm në tregun vendorë. Duke pasur parasysh faktin se shumë pak firma në sektorin kimik janë edhe eksportues, skemat ekzistuese po krijojnë barriera për rritje dhe jo mbështetje reale për bizneset që operojnë në sektorin kimik në Kosovë.
6. **Mungesa e njohurive teknike të përditësuara** - Një nga kufizimet kryesore me të cilat ballafaqohen prodhuesit e kimikateve në Kosovë është njohuria e kufizuar për përmirësimin e teknologjive të procesit apo për zhvillimin e produkteve të reja. Mungesa në tregun e punës për disa profesione kyçe, si teknologët kimikë, krijojnë një pengesë kritike ndaj rritjes për kompanitë e sektorit. Pasi që sektori kimik në Kosovë i duhen më shumë njohuri, mungesa e aftësive teknike ndikon në cilësinë dhe konkurrencën e produkteve përfundimtare, gjë që nga ana tjetër ka një ndikim negativ në konkurrencën e prodhuesve kimikë. Harmonizimi i sistemit arsimor me nevojat e industrisë është shumë i dobët. Në mënyrë të ngjashme, bashkëpunimi dhe sinergjia ndërmjet institucioneve arsimore dhe akterëve të industrisë janë gjithashtu të dobëta.
7. **Njohuri të pakta për tregun** - Qasja në tregje varet kryesisht nga informacioni dhe njohuritë që prodhuesit kanë për kërkesat në secilin treg specifik, qoftë në aspektin e standardeve të cilësisë, llojet e produkteve të kërkuara ose flukset e përgjithshme të kërkesës. Ndërmarrjet e përpunimit kimik në Kosovë kanë pak njohuri për këto trende të tregut dhe dinamikën e tyre. Gjithashtu, ka pak informata lidhur me mundësitë e qasjes në tregjet e eksportit përmes panaireve ndërkombëtare. Nuk ka panairë specifike të mbështetura nga sektori publik që synojnë prodhuesit e kimisë, dhe pothuajse asnjë përpjekje nga NMVM-të e sektorit për të organizuar promovime të përbashkëta.
8. **Mungesa e trupave certifikuese dhe laboratorëve pengon potencialin e eksportit** - Produktet që do të eksportohen në BE duhet të plotësojnë një gamë të gjerë standardesh dhe rregulloresh vullnetare dhe të detyrueshme. Mungesa e disponueshmërisë së trupave vendore të certifikimit dhe laboratorëve të testimit, të cilët janë në gjendje të lëshojnë certifikata dhe raporte testimi të njohura ndërkombëtarisht, mbetet një barrierë e madhe për firmat e orientuara nga eksporti. Për më tepër, mungesa e shërbimeve, si laboratorët e specializuar për kryerjen e testimit dhe kontrollit të produktit është një barrierë kyçe për sektorin. Kjo plotësohet nga mungesa e njohurive teknike të disponueshme në vend që i ndihmon kompanitë e përpunimit kimik të marrin në konsideratë standarde të tilla tashmë gjatë projektimit të produkteve. Firmat duhet të blejnë shërbime të testimit, certifikimit ose konsulencës nga jashtë, gjë që është një sfidë e dedikuar. Shumica e kompanive thjesht nuk mund të përballojnë shërbimet e tilla. Prandaj ata marrin çmime të ulëta nga blerësit, pasi ata zakonisht kujdesen për testimin dhe certifikimin e detyrueshëm gjatë importimit të produkteve. Këto shërbime shtesë duhet të paguhet nga eksportuesit kosovarë me çmim të lartë.

8. Rekomandimet për ndërhyrje

Pavarësisht faktit se sektori i përpunimit kimik është zhvilluar pozitivisht gjatë viteve të fundit, ai ka ende një status të brishtë. Kjo është arsyeja se pse ky sektor është anashkaluar për vite të tëra. Megjithatë, gjetjet kanë zbuluar se ky sektor ka potencial në rritje. Kushtet e duhura kornizë mund të ndihmojnë sektorin dhe aktet e lidhur të rriten dhe të fitojnë fuqi të mëtejshme. Megjithatë, këto kushte kornizë nuk janë realisht të favorshme për sektorin e përpunimit kimik në Kosovë. Objektivat kryesore të ndërhyrjeve të propozuara synojnë të përmirësojnë konkurrencën e gjithë sektorit të përpunimit kimik, duke adresuar në mënyrë specifike barrierat dhe kufizimet e identifikuar (shih Figura 26). Qëllimi i përgjithshëm mund të arrihet përmes një sërë ndërhyrjesh në nivel institucional dhe programor. Këto ndërhyrje do të përfshihen në qasjen strategjike afatgjatë dhe angazhimin e Qeverisë së Kosovës për të përmirësuar kushtet kornizë të sektorit të përpunimit kimik në Kosovë. Grupi i ndërhyrjeve të propozuara përbëhet nga mbështetja institucionale dhe programore, që trajton një ose disa barrierat e identifikuar në këtë studim (shih Kapitullin 7). Fokus i kushtohet ndërhyrjeve/rekomandimeve të tilla, të cilat janë në kuadër të MINT-së.


Shumica e rekomandimeve nuk janë të destinuara në mënyrë eksplicite për sektorin e përpunimit kimik por edhe për sektorët e tjerë të prodhimit në Kosovë, si sektori i prodhimit të metaleve, sektori i ushqimit dhe pijeve, etj.

Figura 27: Teoria e ndryshimit të ndërhyrjeve të propozuara



Burimi: Anteja EGC

Figura 28. Shtatë ndërhyrje të propozuara dhe trajtimi i fushave të përmirësimeve



Burimi: Anteja ECG

Bazuar në gjetjet e fituara, propozohet një grup ndërhyrjesh që trajtojnë një nga disa fushat e përmirësimit, siç janë paraqitur në Figurën 27.

Rekomandimi 1: Mbështetja e zhvillimit të fuqisë punëtore

Arsyetimi: Modeli i rritjes së sektorit të përpunimit kimik ka pasoja të mëdha dhe kërkon aftësimin e punëtorëve dhe fuqisë punëtore. Sistemi arsimor kombëtar ende nuk është i përgatitur për kërkesat e ardhshme të sektorit të përpunimit kimik. Nuk ka mjaft QAP publike ose universitete që sigurojnë të diplomuar që kanë kompetenca për të cilat ka nevojë sektori. Edhe në rast se do të bëhen përpjekje për përmirësimin e kurrikulës dhe infrastrukturës së qendrave kombëtare të arsimit dhe aftësimin profesional, kjo do të marrë kohë dhe është e paqartë se deri në çfarë mase do të jetë e mundur që këto institucione të ofrojnë mbështetjen që është realisht e nevojshme.

Andaj, duhet të identifikohen mënyra të reja se si të mbështetet më mirë dhe më shpejt zhvillimi i aftësive në sektorin e përpunimit kimik. Barrierat kryesore për mbështetjen e punonjësve në zhvillimin e aftësive janë mungesa e njohurive për nevojat e trajnimit, mungesa e ofruesve të trajnimit dhe mungesa e mjeteve financiare të prodhuesve mikro dhe të vegjël.

Një ndërhyrje premtuese mund të jetë një skemë granti për zhvillimin e aftësive.³⁶ Përfituesit e skemës së grantit janë NMVM-të dhe zejtaritë nga sektori i përpunimit kimik, të cilët mund të marrin këshilla në formulimin e strategjive të aftësive dhe mbështetje financiare për zhvillimin e aftësive përmes vauçerëve të trajnimit.

- Kompanitë mund të marrin mbështetje në vlerësimin e nevojave për trajnim të punëtorëve të tyre, p.sh. pjesë e një strategjie të aftësive, e cila mund të merret si parakusht për aktivitetet e ardhshme të trajnimit.
- Kompanitë mund të marrin vauçer për programet e trajnimit të cilat janë të rëndësishme për zhvillimin e aftësive të detyrueshme.
- Ofruesit e arsimit dhe trajnimit, organizatat shkencore, shoqatat ose organizatat anëtare të biznesit mund të marrin mbështetje për të zhvilluar dhe zbatuar programe të reja trajnimi dhe mbështetje shtesë për krijimin e partneriteteve ndërkombëtare me ofruesit e trajnimit nga jashtë.

Fushëveprimi i kësaj skeme vauçer do të përqendrohet në përpunimin kimik dhe fushat e lidhura me to. Për shkak të transformimit në rritje të industrisë kimike, skema do të inkurajojë gjithashtu zhvillimin e aftësive dixhitale. Vauçerët mbulojnë shpenzimet për

- Kostot e personelit të trajnerëve për orët/ditët gjatë të cilave trajnerët marrin pjesë në trajnim.
- Kostot operative të trajnerëve dhe të kursantëve që lidhen drejtpërdrejt me projektin e trajnimit, siç janë shpenzimet e udhëtimit, kostot e akomodimit, materialet dhe furnizimet që lidhen drejtpërdrejt me projektin, amortizimi i mjeteve dhe pajisjeve, në masën që ato përdoren ekskluzivisht për projektin e trajnimit.
- Kostot e shërbimeve këshillimore të lidhura me projektin e trajnimit, dhe
- Kostot e personelit të kursantëve dhe kostot e përgjithshme indirekte (kostot administrative, qiraja, shpenzimet e përgjithshme) për orët gjatë të cilave të trajnuarit marrin pjesë në trajnim.

Nëse zbatohet me sukses, kjo skemë granti mund të rrisë ndërgjegjësimin për nevojën e shtuar për të investuar tek punonjësit e saj. Ajo lehtëson hartimin dhe zbatimin e programeve të trajnimit të personalizuar, por gjithashtu lejon ofruesit e trajnimit të zgjerojnë njohuritë e tyre.

Shembull i praktikës së mirë

Shoqëria Mbretërore e Kimisë (MB) ka zbatuar një program vauçer për zhvillimin e aftësive për të mbështetur NVM-të që përballen me sfidën e mungesës së njerëzve me aftësitë e nevojshme teknike. Prandaj, Shoqëria Mbretërore e Kimisë ka ofruar vauçer trajnimi, secila me vlerë deri në EUR 1,200 për të rimbursuar koston e një kursi trajnimi për një anëtar të stafit të anëtarët. Vauçeri ka qenë i përshtatshëm për t'u përdorur për trajnime teknike, të biznesit ose të 'aftësive të buta': cilado që plotësonin më së afërmi nevojat e anëtarëve. Çdo kurs nga një furnizues me reputacion ka qenë i pranueshëm, por Shoqëria Mbretërore e Kimisë gjithashtu mbështeti anëtarët e saj për të identifikuar kurse të përshtatshme trajnimi.

Skema e vauçerëve është aplikuar në janar 2021 dhe ka mbetur e hapur gjatë gjithë vitit për të qenë të sigurt që ishte bërë një numër i mjaftueshëm aplikimesh. Procesi i aplikimit ishte shumë i lehtë për të ulur çdo barrierë të mundshme nga NVM-të për të aplikuar. Pas aplikimit të suksesshëm, përfituesit i janë lejuar tre muaj për të rezervuar kursin dhe për të kërkuar paratë për vauçerin e tyre. Anëtarët u lejuan të aplikojnë për një vauçer trajnimi për një periudhë gjashtëmuajore³⁷.

³⁶ Kjo skemë granti do të jetë e hapur për të gjithë sektorët e prodhimit, jo vetëm ushqimin dhe pijet, si prodhimin e metaleve apo drurit, industrinë e tekstilit apo kimike.

³⁷ Shoqëria Mbretërore e Kimisë, <https://www.rsc.org/sme/training-vouchers/#eligible>

Rekomandimi 2: Krijimi i një kllasteri për përpunim kimik, "Kllasteri i Kimisë në Kosovë"

Arsyetimi: Peizazhi kombëtar i organizatave anëtare të biznesit, shoqatave sektoriale dhe iniciativave kllaster është ende i brishtë ose as që ekziston. Deri më tani, nuk ka as një shoqatë sektoriale dhe as një rrjet rajonal apo iniciativë kllaster. Paralelisht, duket se ka një interes në rritje të bizneseve në sektorin e përpunimit kimik për rrjetëzim, shkëmbim përvojash dhe bashkëpunim. Nuk ka dyshim se subjekte të tilla luajnë rol të rëndësishëm. Kur shikojmë vendet fqinje (p.sh. Bosnja dhe Hercegovina ose Serbia), bëhet e qartë se vende të tilla kanë një peizazh kllaster shumë më të pjekur.

Objektivi kryesor i intervenimit të propozuar, "Kllasteri i Kimisë në Kosovë", është përmirësimi i konkurrencës së ndërmarrjeve në sektorin e përpunimit kimik, duke u mundësuar atyre të rrjetëzohen, të bashkëpunojnë, të shkëmbejnë përvoja dhe madje të angazhohen në aktivitete me vlerë më të shtuar. Objektivat do të arriheshin nëpërmjet mbështetjes së një iniciative të tilla kllaster, e cila funksionon si organizatë anëtare e biznesit që promovon aktivitete të tilla midis bizneseve të lidhura. Këto aktivitete do të mundësohen përmes organizimit të kllasterëve profesional. Ndërhyrja do të mbështesë organizatën kllaster për të ofruar shërbime për një sërë aktivitetsesh, duke përfshirë rrjetëzimin, përputhjen, ndërmjetësimin e aftësive, ofrimin e trajnimit, ndërkombëtarizimin, bashkimin e kapaciteteve prodhuese ose aktivitetet e përbashkëta të inovacionit. Mbështetja e ofruar nga një organizatë e tillë kllaster do të rrisë kapacitetin e anëtarëve të grupit përfitues për të bashkëpunuar, rrjetëzuar dhe inovuar, gjë që do t'u mundësojë atyre të bëhen më konkurrues në sektorin e tyre kyç.

Ndërhyrja e propozuar do të mbështesë organizatën kllaster në:

- Frymëzimin e iniciativës kllaster për të lehtësuar bashkëpunimin, shkëmbimin e informacioneve dhe ofrimin ose drejtimin e shërbimeve të specializuara dhe të personalizuar të mbështetjes së biznesit,
- Rritjen e ndërgjegjësimit të firmave kllaster për tendencat përkatëse, ndryshimin e kërkesave të tregut dhe potencialet e inovacionit,
- Këshillimin dhe mentorimin e firmave kllaster për krijimin e partneriteteve dhe përputhjeve të përbashkëta,
- Vlerësimin e nevojave për trajnim të firmave kllaster, si dhe mbështetjen për përdorimin e vauçerëve të trajnimit (shih Rekomandimi 1),
- Fillimin e bashkëpunimit ndërkombëtar të biznesit dhe përfshirjen në zinxhirët global të vlerës (në përputhje me agjencitë kombëtare për promovim të eksporteve, si KIESA),
- Fillimin e transferimit të teknologjisë dhe komercializimi i inovacionit, duke marrë rolin e ndërmjetësit dhe përsheptuesit të teknologjisë,
- Aktivitetet e brendimit dhe komunikimit,
- Organizimin e forumeve, grupeve të punës, seminareve, apo formateve të tjera për shkëmbimin e njohurive dhe përvojës,
- Zhvillimin dhe zbatimin e aktiviteteve dhe shërbimeve që kontribuojnë në rrjetëzimin, shkëmbimin e përvojave, ndërtimin e besimit, shkëmbimin e njohurive, zhvillimin e aftësive, gjenerimin e biznesit ose zhvillimin e ndërsjellë të produkteve, teknologjive ose shërbimeve inovative,

Shembull i praktikës së mirë**Chemie Cluster Bavaria**

Në vitin 2006, në kuadër të Iniciativës Kllaster të Bavarias, u themelua Chemie Cluster Bavaria (Kllasteri i Kimisë Bavaria). Iniciativa e Qeverisë së Shtetit Bavarez synonte të rriste konkurrencën e Bavarisë në fushën e teknologjisë së proceseve kimike. Me kalimin e kohës, menaxhimi kllaster krijoi një rrjet të dendur firmash vendore dhe ndërkombëtare që u mundësuan kompanive dhe institucioneve kërkimore të bashkëpunojnë, të rrjetëzohen dhe të krijojnë së bashku zgjidhje inovative. Qasja e kllasterëve ka vërtetuar se rrjetëzimi mund të ndihmojë në lidhjen e akterëve përgjatë zinxhirëve të vlerës nga hulumtimi dhe zhvillimi e deri tek produkti përfundimtar.

Nga qasja në rrjetin ndërsektorial, rajonal dhe ndërkombëtar përfitojnë mbi 100 anëtarë të Kllasterit të Kimisë Bavaria. Falë ekipit profesional të menaxhimit kllaster, ai mund t'u përgjigjet kërkesave specifike të anëtarëve të saj në lidhje me zhvillimin dhe bashkëpunimin. Forumet tematike vjetore ofrojnë mundësinë ideale për t'u ndërlidhur me anëtarët e tjerë, për të shkëmbyer njohuri ose për të diskutuar temat më të fundit.

Platforma e Biznesit dhe Inovacionit Kimik është përgjegjëse për zbatimin e projekteve dhe bashkëpunimeve. Duke përdorur zbulimin e teknologjisë, menaxhimi kllaster ka identifikuar teknologjitë dhe produktet e reja të mundshme, dhe vepron si ndërmjetës dhe katalizator neutral midis partnerëve të bashkëpunimit. Menaxhimi kllaster mbështet më tej anëtarët në zhvillimin e ideve të reja të biznesit ose produktit.

Në bashkëpunim me Universitetin e Bayreuth dhe në Kampusin TUM Straubing, Kllasteri i Kimisë Bavaria u ofron anëtarëve mbështetje në zhvillimin e aplikimeve për grante rajonale ose kombëtare. Përveç zhvillimit dhe menaxhimit të projektit gjatë procesit të aplikimit, menaxhimi kllaster ofron gjithashtu ndihmë në menaxhimin e projektit gjatë gjithë periudhës së projektit.

Burimi: Kllasteri i Kimisë Bavaria

Rekomandimi 3: Krijimi i një sistemi vauçer për të përmirësuar nivelin e dixhitalizimit brenda NMVM-ve

Arsyetimi: Gjetjet tregojnë se niveli i dixhitalizimit brenda NMVM-ve nga sektori i përpunimit kimik është krahasueshëm i ulët. Mund të ketë arsye të ndryshme për këtë vështirësi. Ndërmarrjet në Kosovë nuk janë në gjendje të investojnë në dixhitalizim. Për më tepër, shpesh nuk ka njohuri të mjaftueshme brenda ndërmarrjes për të vendosur se ku dhe si të fillojë. Së fundi, ndërmarrjet shpesh vuajnë nga mungesa e qasjes tek ofruesit e kualifikuar të shërbimeve të biznesit që mund t'i mbështesin ato në përputhje me rrethanat.

Rekomandohet hartimi dhe zbatimi i një të ashtuquajturit Program Vauçer për Dixhitalizim për t'iu përgjigjur si duhet kufizimeve të sipërpërmendura. Një program i tillë vauçer zakonisht përbëhet nga stimujt ekonomik të dhënë nga qeveritë lokale, rajonale dhe kombëtare për ndërmarrjet, me synimin për të adresuar qëllimet e paracaktuara. Në këtë kontekst, programet vauçerë synojnë kryesisht NMVM-të. Programet vauçerë janë të vendosur mirë në Evropë dhe më gjerë, dhe janë provuar të jenë një mjet efektiv për të mbështetur NMVM-të në fusha të ndryshme. Gjersa në të kaluarën, vauçerët e inovacionit ishin lloji mbizotërues i vauçerëve, sot vauçerët lëshohen gjithashtu për të mbështetur ndërmarrjet në dixhitalizim (p.sh. Vauçer për dixhitalizim, Belgjikë³⁸) ose transformim (p.sh. Vauçer për Transformim, Baden-Württemberg).³⁹

38 <https://editx.eu/en/it-challenge/digital-transformation-challenge-belgium-2019>
39 <https://wm.baden-wuerttemberg.de/de/innovation/innovationsgutscheine/> (në gjuhën Gjermane)

Rekomandohet zbatimi i një programi vauçer që stimulon aktivitetet e ndërlidhura me dixhitalizimin brenda ndërmarrjeve. Vauçerët mund të përdoren nga ndërmarrjet për të marrë mbështetje nga konsulentët, ofruesit e trajnimit ose institucionet e K dhe ZH. Mbështetja e kërkuar mund të mbulojë

- Diagnostikimin dhe auditimin e dixhitalizimit
- Shërbimet e lidhura me dixhitalizimin
- Shërbimet këshilluese për biznesin, duke përfshirë strategjinë e dixhitalizimit.

Shembull i praktikës së mirë

Qeveria e Baden-Württemberg (Gjermani) u lëshon vauçerë bizneseve lokale për inovacion dhe dixhitalizim, për të stimuluar investimet në transformim dhe dixhitalizim. Vauçerët mbështesin zbatimin e masave të ndryshme dhe mbulojnë kostot deri në EUR 50,000.

Në vitin 2008, Baden-Württemberg u bë shteti i parë gjerman që aplikoi vauçerët e inovacionit për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme. Programi mbështet NVM-të në planifikimin, zhvillimin, zbatimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të produkteve, shërbimeve ose proceseve të prodhimit inovativ. Në vitin 2012, programi u zgjerua për të përfshirë vauçerin e inovacionit për fillimin e teknologjisë së lartë. Ai synon fillimet e teknologjisë së lartë deri në maksimum pesë vjet pas themelimit, dhe mbështet projekte inovative nga fushat në rritje të së ardhmes. Në vitin 2017, u prezantuan vauçerët e inovacionit High-tech Digital dhe High-tech Mobility për të mbështetur kompanitë e themeluara në zhvillimin dhe realizimin e produkteve dhe shërbimeve dixhitale të sofistikuara.

Megjithëse skemat e ndryshme të vauçerëve kanë qëllime të ngjashme, ato lejojnë ofrimin e mbështetjes më të orientuar nga kërkesa. Procesi i aplikimit për vauçerët e ndryshëm është shumë i ngjashëm. Mbështetja varion nga EUR 10,000 deri në EUR 50,000 për vauçer. Një nga përparësitë kryesore të skemës së vauçerëve janë ngarkesat e ulëta administrative dhe periudha e shkurtër e vlerësimit.⁴⁰

Rekomandimi 4: Orientimi i peizazhit të mbështetjes për promovimin e eksporteve

Arsyetimi: Gjetjet kanë treguar se shumë ndërmarrje kanë hyrë me sukses në tregje të reja dhe janë bërë furnizues për partnerë nga jashtë. Eksporti mbetet një nga shtytësit kryesorë të rritjes së qëndrueshme. Edhe pse shumë ndërmarrje tashmë eksportojnë, ka ende hapësirë të konsiderueshme për rritje. Qëllimi përfundimtar do të jetë krijimi i kushteve të favorshme kornizë për ndërmarrjet për t'u bërë ndërkombëtare, gjë që shkon përtej programeve individuale të mbështetjes të drejtuara nga donatorët.

Deri më tani, qeveria ka disa programe në zbatim dhe subjekte të emëruara, si KIESA, për të promovuar përpjekjet për ndërkombëtarizimin e sektorit privat. Megjithatë, këto veprime duken të fragmentuara, jo gjithmonë të harmonizuara, dhe shpesh tradicionale dhe, deri tani, jo të mjaftueshme për të krijuar kushte kornizë të favorshme për promovimin e eksporteve. Mungon çdo strategji sistematike.

Deri më tani, nuk ka instrumente financiare që mbështesin ndërmarrjet e interesuara për dalje në arenën ndërkombëtare. Përderisa vendet e tjera ofrojnë kredi të favorshme që mund t'i ndihmojnë ndërmarrjet të eksportojnë dhe të rrisin biznesin e tyre jashtë vendit apo në sigurimin e transaksioneve të eksportit dhe investimeve jashtë vendit kundër rreziqeve jo të tregtueshme në dispozicion, instrumente të tilla mungojnë në Kosovë. Për më tepër, nevojitet mbështetje që ofron të gjitha aspektet e ndërkombëtarizimit, nga

⁴⁰ <https://wm.baden-wuerttemberg.de/de/innovation/innovationsgutscheine/> (në gjuhën Gjermane)

identifikimi i tregjeve premtuese mbi përputhjen/shkëmbimin B2B me blerësit ndërkombëtarë, e deri tek mbështetja financiare për përpjekjet e ndërkombëtarizimit para-financues, të paktën firmat me potencial të lartë eksporti. Mbështetja e tillë monetare është e rëndësishme, pasi që shumica e bizneseve kosovare janë shumë të vogla me kapacitete të ulëta financiare.

Institucionet ekzistuese, si KIESA, do të forcohen për të ofruar një rol më të fortë dhe më aktiv në këtë drejtim. Pjesëmarrja e rregullt dhe ekspozimi në panaire ndërkombëtare në bashkëpunim me KIESA, trajnimi i firmave se si të ndërkombëtarizohen si dhe fuqizimi i rrjeteve të diasporës janë aktivitete që të gjitha do të ndihmonin sektorin për depërtimin në arenën ndërkombëtare.

Shembull i praktikës së mirë

Ndërkombëtarizimi është pjesë e integruar e Strategjisë Kombëtare të Specializimit të Mençur. Me një pjesë të eksportit prej 80% në vitin 2020, ndërkombëtarizimi është opsioni mbizotërues i rritjes për kompanitë vendore. Rrjedhimisht, Qeveria e Sllovenisë ofron një mjedis mbështetës për bizneset në zhvillim që kërkojnë të lulëzojnë ndërkombëtarisht.

Si pjesë e përpjekjeve të saj për ndërkombëtarizim, Sllovenia krijoi një strategji konsekuente të brendimit për të komunikuar më mirë pikën e saj unike të shitjes ("Ekonomia sllovene është e gjelbër, krijuese dhe e mençur, gjë që dëshmohej nga fokusi i saj në ekonominë e gjelbër dhe zhvillimin e qëndrueshëm, për t'u bërë një shoqëri e avancuar me karbon të ulët, që i përgjigjet në mënyrë aktive sfidave globale dhe bashkë-krijon tendenca të reja"). Qeveria sllovene dhe organet institucionale publike ofrojnë shumë shërbime pa pagesë për partnerët, investitorët, furnizuesit dhe eksportuesit ekzistues dhe potencialë sllovenë, duke i ndihmuar atyre që të përmirësojnë operacionet e tyre ndërkufitare, duke rritur diversifikimin gjeografik të eksporteve sllovene dhe duke krijuar kushte më të mira për kompanitë sllovene në tregjet e huaja. SPOT Global, i drejtuar nga SPIRIT Slloveni, funksionon si një qendër e vetme për të gjithë informacionin e nevojshëm.⁴¹ Subjektet e përfshira në masat mbështetëse të ndërkombëtarizimit janë të pajisura në mënyrë adekuate dhe funksionojnë në mënyrë profesionale. SPIRIT është i ngarkuar edhe me zbatimin e skemave ekzistuese të mbështetjes financiare për promovimin dhe ndërkombëtarizimin e eksporteve.

Skemat mbështetëse kanë të bëjnë me:

- promovimin e konkurrencës dhe qëndrueshmërisë së eksporteve sllovene,
- tërheqjen, mbështetjen dhe mbajtjen e investitorëve të huaj në Slloveni,
- mbështetjen e kompanive sllovene që investojnë jashtë vendit,
- përmirësimin e dukshmërisë ndërkombëtare të ekonomisë sllovene,
- përmirësimi i funksionimit të vetë ekosistemit mbështetës të ndërkombëtarizimit.

Përveç masave tradicionale, si bashkëfinancimi i kërtimeve të tregut dhe aktiviteteve që lidhen me panairt tregtare dhe ngjarjet e biznesit për të inkurajuar kompanitë për të hyrë në tregjet e huaja, mbështetja synohet gjithashtu në forma të reja të inkurajimit të ndërkombëtarizimit të kompanive, d.m.th., dixhitalizimi i kompanive, e-përmbajtja si pjesë e operacioneve të biznesit, modeleve të reja të biznesit, partneriteteve me synimin për të hyrë së bashku në një treg të huaj të zgjedhur dhe iniciativa të ngjashme.

Përveç kësaj, mbështetja është gjithashtu e fokusuar tek furnitorët, që përfshijn informacione të personalizuar për furnitorët sllovenë, një bazë të dhënash të eksportuesve sllovenë Sloexport, shpërndarjen e kërkesës suaj midis eksportuesve sllovenë, organizimin e misionëve për gjetjen e fakteve, lidhjet me industrinë dhe autoritetet lokale, dhe këshilla për çështje praktike. Informacion më të detajuar për furnitorët potencialë sllovenë, mjedisin e biznesit, industrinë dhe informacione të tjera specifike për biznesin mund të gjenden në portalin Sllovenia Partnere.

Burimi: <https://www.sloexport.si/en/About-us>

⁴¹ <https://www.sloveniabusiness.eu/>

Rekomandimi 5: Krijimi dhe zbatimi i një Fondi të Inovacionit

Arsyetimi: Gjetjet kanë dëshmuar se shumica e prodhuesve të metaleve nuk kanë investuar as në inovacion dhe as në procese të transformimit dixhital. Një aftësi e ulët për të inovuar, diversifikuar ose për t'u përshtatur me klientët e ardhshëm është pasoja logjike. Shumë nga të anketuarit janë plotësisht të vetëdijshëm për investime të tilla, por ata nuk kanë qasjen e duhur në financa dhe njohuri. Ndërhyrja "Fondi i Inovacionit" i përgjigjet kësaj situate, duke përmirësuar konkurrencën e firmave nga sektorë të ndryshëm kyç, duke përfshirë teknologjitë e proceseve kimike, duke promovuar diversifikimin dhe duke u mundësuar firmave përfituese të angazhohen në aktivitete me vlerë të shtuar. Skema do të mbështesë projekte bashkëpunuese të inovacionit dhe transformimit dixhital që bashkojnë kompani të ndryshme ose kompanitë dhe organizatat kërkimore për zhvillimin e teknologjive të reja dhe produkteve, si dhe shërbimeve të reja ose të përmirësuara.

Për të arritur këtë qëllim, qasja e propozuar do të çojë në:

- Rritjen e kapaciteteve inovative të ndërmarrjeve përmes granteve të përputhshme. Mbështetjen e ofruar në formën e granteve të tilla për zhvillimin e produkteve, proceseve dhe shërbimeve të reja do të mundësojë 1) përmirësimin e disponueshmërisë së financimit për aktivitetet e inovacionit, 2) rritjen e aktiviteteve të transferimit të njohurive dhe teknologjisë (duke mbështetur kërkimin kontraktual, blerjen dhe licencimin e të drejtave të pronësisë intelektuale (DPI) dhe asete të tjera jo-materiale), 3) rritjen e qasjes në shërbimet këshilluese dhe mbështetëse të inovacionit, 4) rritjen e personelit të disponueshëm për aktivitetet e inovacionit dhe 5) disponueshmërinë e përmirësuar të objekteve dhe pajisjeve cilësore kërkimore.
- Përmirësimin e lidhjeve me akterët e inovacionit. Mbështetja e ofruar për konzorciumet do të inkurajojë dhe forcojë lidhjet dhe partneritetet e inovacionit midis akterëve të inovacionit brenda sektorit të përpunimit kimik.

Gjatë viteve të fundit, GIZ CETEP, i mbështetur nga MINT, ka ofruar mbështetje financiare për NVM-të përmes një skeme të grantit "Fondi i Inovacionit". Në vitet 2018 dhe 2019 janë shpërblyer shumë projekte. Në rast se do të zbatohet një Fond i tillë Inovacioni, ai mund të ndërtohet në përvojat e arritura më parë.

Objektivi i Fondit të Inovacionit është që t'i përgjigjet situatës aktuale, duke përmirësuar konkurrencën e firmave brenda sektorit të prodhimit, duke promovuar diversifikimin dhe duke u mundësuar firmave përfituese të angazhohen në inovacion (dhe K dhe ZH). Skema do të mbështesë projekte inovative bashkëpunuese, të cilat bashkojnë kompani të ndryshme ose kompanitë dhe organizatat kërkimore për zhvillimin e teknologjive të reja dhe produkteve dhe shërbimeve të reja ose të përmirësuara.

Shembull i praktikës së mirë

Serbia ka qenë një nga vendet e para të Ballkanit Perëndimor që ka miratuar të ashtuquajturin imperativ të inovacionit - ideja se pjesëmarrja e suksesshme në ekonominë botërore, e bazuar në njohuri, mbështetet në aftësinë për të inovuar dhe përshtatur kapacitetet teknologjike dhe kërkimore bazuar në një qasje bashkëpunuese. Fondi i Inovacionit ka ekzistuar për më shumë se 10 vite, dhe synon kryesisht të rrisë kapacitetin e NVM-ve dhe bizneseve fillestare, si dhe burimet e disponueshme për rritjen e tyre. Kështu, fondi është pjesë e një strategjie më të gjerë shtetërore të inovacionit.

Misioni i Fondit është që të mbështesë zhvillimin e inovacionit përmes instrumenteve të duhura mbështetëse financiare, teknike dhe këshillimore, në mënyrë që të fuqizojë ndërmarrjet inovative dhe të forcojë lidhjen midis Kërkimit dhe zhvillimit nga njëra anë, dhe sektorit të biznesit nga ana tjetër, duke respektuar standardet më të larta etike, standardet dhe praktikat financiare dhe të biznesit.

Fondi synon të përmirësojë lidhjet midis shkencës, teknologjisë dhe ekonomisë dhe të kontribuojë në inkurajimin e zhvillimit të sipërmarrjes inovative nga:

- mbështetja e ndërmarrjes inovative, veçanërisht në fazat e hershme të zhvillimit.
- lidhja e organizatave kërkimore shkencore dhe kompanive private për zhvillimin dhe komercializimin e inovacioneve.
- mundësimi i produkteve, teknologjive dhe shërbimeve të reja për të hyrë në tregun ndërkombëtar.
- vendosja e mbështetjes afatgjatë institucionale të shtetit për sipërmarrjen inovative në bashkëpunim me institucionet financiare ndërkombëtare, organizatat, donatorët dhe sektorin privat.

Deri më tani, më shumë se EUR 65 milionë janë ndarë për programet e Fondit. Në të njëjtën kohë, një nga prioritetet e Qeverisë së Republikës së Serbisë është përmirësimi i konkurrencës së shkencës, kërkimit dhe inovacionit në funksion të zhvillimit ekonomik, gjë që reflektohet në sigurimin e fondeve më të mëdha për financimin e inovacioneve përmes Fondit, e sidomos që nga viti 2018.

Që nga fillimi i tij, Fondi i Inovacionit ka financuar 340 projekte inovative.⁴²

Burimi: Fondi i Inovacionit Serbi

Rekomandimi 6: Zvogëlimi i varësisë prej lëndës së parë nga jashtë

Arsyetimi: Shumë kompani kosovare të përpunimit të kimikateve mbështeten fuqishëm në furnizuesit e jashtëm të lëndëve të para. Figura 11 tregon se vetëm një e treta e lëndës së parë të përdorur nga ndërmarrjet vendore merret në vend. Kryesisht kompani nga sektori i kozmetikës burojnë në vend ose nga vendet e afërta. Rritja e përdorimit të lëndëve të para primare vendore mund të ketë efekte pozitive në sigurinë e furnizimit për këtë sektor. Për sa i përket firmave kozmetike natyrore, ato mund të motivohen për të kultivuar më shumë lëndë të para në vend, gjë që ka gjasa të jetë e mundur. Madje ka një kërkesë në rritje nga vendet e BE-së për Bimë Aromatike Mjekësore si lëndë e parë për produktet kozmetike. Investimet në këtë fushë mund t'i kthejnë firmat e kozmetikës natyrore nga Kosova në ofrues konkurrues të lëndëve të para natyrore. Për shembull, Wala Heilmittel GmbH⁴³ filloi prodhimin e vet të Arnicës, Sherebelës dhe Kalendulës në Kosovë, për të siguruar një furnizim afatgjatë.

⁴² Për më shumë informacione: <http://www.inovacionifond.rs/en/fond/about-fund>

⁴³ <https://www.wala.world/en/>

Për sa i përket kompanive që prodhojnë bojëra, veshje dhe ngjitës, ato mbeten të varura nga lëndët e para fosile nga jashtë. Megjithatë, kompani të tilla mund të mbështeten për të konsumuar më pak lëndë të parë duke përmirësuar efikasitetin e materialeve dhe burimeve. Kjo mund të arrihet nëpërmjet një programi stimulum investimi për makineritë dhe teknologjitë e reja që kanë më pak të dhëna (s. rekomandimi 7 i raportit të hartëzimit të zinxhirit të vlerës së ushqimit dhe pijeve) ose duke mentoruar/këshilluar për efikasitetin e lëndës së parë (s. rekomandimi 4 i prodhimit të metaleve raporti i hartëzimit të zinxhirit të vlerës).

Shembull i praktikës së mirë

Me miratimin e Programit Gjerman për Efikasitetin e Burimeve (ProgRes), Gjermania ishte ndër vendet e para që përcaktoi objektivat, parimet udhëzuese dhe qasjet për reduktimin e varësisë nga furnizimi i jashtëm i lëndëve të para. Qëllimi kryesor i Programit Gjerman për Efikasitetin e Burimeve është të bëjë nxjerrjen dhe përdorimin e burimeve natyrore më të qëndrueshme dhe për të zvogëluar varësinë nga vendet e treta.

Programi ofron një spektër të gjerë masash mbështetëse, siç tregohet më poshtë.

Furnizimi me lëndë të para	Strategjia e lëndëve të para	Lëndët e para të rinovueshme	Qëndrueshmërinë dhe transparencën
Prodhimi	Konsultimi i efikasitetit	Prodhim efikas	Dizajni i produktit
Konsumimi	Ndërgjegjësimi	Shitësit me pakicë dhe konsumatorët	Sistemet e certifikimit
Ndërtesa	Infrastruktureës	Ndërtim, zhvillim, rinovim	Etiketimi i produkteve të ndërtimit
TIK	Produkte efikase	Softuer efikas	Prokurimit publik
Instrumente	Kërkimin dhe inovacionin	Arsimimi	Kuadri ligjor

ProgRes ofron mbështetje për rritjen e efikasitetit të lëndës së parë përgjatë gjithë zinxhirit të vlerës – nga nxjerrja e lëndës së parë dhe dizajni i produktit, e deri tek prodhimi, përdorimi dhe ekonomia qarkore. Një aspekt i programit është adresimi i sfidave aktuale në mënyrë që të përmirësohet më tej efektiviteti i programit.

Ndër të tjera, programi mbështet prodhimin me efikasitet material dhe energji dhe proceset e rikuperimit të lëndëve të para. Duke rritur efikasitetin e materialit dhe duke mbyllur ciklet e materialit, jo vetëm që duhet të rritet siguria e furnizimit, por edhe të kontribuojë në mënyrë të synuar në lehtësimin mjedisor duke kursyer lëndët e para të papërpunuara.⁴⁴

44 Burimi: Ministria Federale për Mjedisin, Ruajtjen e Natyrës, Sigurinë Bërthamore dhe Mbrojtjen e Konsumatorit, 2022

Rekomandimi 7: Krijimi i një sistemi të harmonizuar ndërkombëtarisht të vlerësimit të konformitetit

Arsyetimi: Shumë biznese kosovare u shërbejnë kompanive ndërkombëtare të ndërtimit duke i furnizuar me ngjyra dhe lyerje. Këto produkte i përkasin materialeve të ndërtimit për të cilat certifikimi është shpesh i detyrueshëm (p.sh. sipas Rregullores së BE-së 649/2012 dhe Vendimit të Këshillit të BE-së 2006/730/KE). Sistemi kombëtar i vlerësimit të konformitetit të Republikës së Kosovës nuk njihet ndërkombëtarisht dhe, për rrjedhojë, nuk mund të ofrojë certifikata të tilla. Kjo rezulton në një disavantazh të dedikuar konkurrues. Barriera të ngjashme tregtare ekzistojnë për ofruesit kosovarë të banjove dhe shamponeve apo produkteve të pastrimit.

Edhe pse në të kaluarën, ka pasur disa aktivitete të donatorëve ndërkombëtarë për të përmirësuar sistemin kombëtar të vlerësimit të konformitetit, Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit të Kosovës (DAK) ende ka statusin e një anëtari të asociuar, por jo një anëtari të plotë të AE. Rajonet kryesore konkurruese, si Serbia, Rumania dhe Maqedonia e Veriut, kanë një sistem konformiteti të njohur ndërkombëtarisht. Duhet të bëhen më shumë përpjekje nga ana e DAK-së për të përmbushur kërkesat ndërkombëtare të dhëna nga AE. Rekomandohet të vendosni një udhërrëfyes të besueshëm, përfshirë një plan veprimi, se si DAK dhe Qeveria e Kosovës do t'i përmbushin kërkesat për t'u bërë anëtare e plotë e AE dhe nevojiten veprime mbështetëse. Një rishikim i ndërsjellë i kolegëve me një nga anëtarët e plotë të AE mund të ndihmojë në identifikimin e dobësive dhe hapësirës për përmirësim.

9. Rruga përpara

Studimi ka treguar se janë disa nën-sektorë brenda industrisë kimike në Kosovë që janë zhvilluar mirë gjatë viteve të fundit. Orientimi i lartë drejt eksportit tregon gjithashtu se kompanitë në këta nën-sektorë mund të konkurrojnë në nivel ndërkombëtar. Trendi aktual drejt qëndrueshmërisë më të lartë mund të nxisë edhe më shumë kërkesën për produkte kosovare. Kalimi nga bojërat dhe veshjet me bazë tretësi në ato me bazë uji për sektorin e ndërtimit, dhe përbërësit natyralë për produktet kosovare të banjës dhe dushit/ kozmetikës dhe pastrimit janë alternativa që do të jenë shumë të kërkuara në të ardhmen.

Pavarësisht nga zhvillimet tërësisht premtuese për nën-sektorët e identifikuar të sektorit të përpunimit kimik, ka edhe disa sfida që duhen përballuar në mënyrë që sektori të përfitojë realisht nga potenciali i ardhshëm. Vendet fqinje janë ende shumë më të forta në nën-sektorët e identifikuar dhe gjithashtu janë zhvilluar relativisht mirë vitet e fundit. Kjo konkurrencë duhet të zotërohet me sukses për të përmirësuar më tej pozitën konkurruese të firmave kosovare.

Rekomandimet e propozuara tregojnë zgjidhje konkrete që mund të ndihmojnë sektorin të ruajë dhe zgjerojë më tej konkurrencën e tij. Megjithatë, për të qenë i suksesshëm, kërkohen investime të konsiderueshme publike dhe private. Masat e propozuara synojnë pikërisht t'i japin sektorit privat udhëzime konkrete në mënyrë që ai të investojë më lehtë në teknologjitë dhe njohuritë e ardhshme. Në këtë mënyrë, mund të jetë e mundur të mbështetet sektori i përpunimit kimik në mënyrë të qëndrueshme.

Ndërhyrjet e rekomanduara nuk varen vetëm nga projektimi i përshtatshëm, por edhe nga zbatimi profesional. Megjithatë, ka pak përvojë se si të zbatohen ndërhyrje të tilla dhe programeve të tilla mbështetëse në vend. Është e rëndësishme të shmangen gabimet e së kaluarës, të cilat janë bërë në shumë vende të Ballkanit Perëndimor. Ndërhyrjet duhet të zbatohen në mënyrë të orientuar drejt kërkesës, duhet të jenë të shpejta dhe relativisht jo-burokratike. Kompanitë kanë nevojë për vendime të shpejta dhe pritje me muaj të tërë.

Studimi hedh themelet për një dialog publik-privat rreth gjetjeve dhe ndërhyrjeve të propozuara, të cilat në fund duhet të çojnë në një përdorim të synuar të fondeve të kufizuara publike ku ato mund të kenë ndikimin më të madh në sektorin e përpunimit kimik.

